Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministia e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

UDHËZUES PRAKTIK *PËR PRINDËR*

Prishtinë, 2015

Botues Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Redaktor përgjegjës
Labëri Luzha

Lektor:
Milot Rudi

Autorët e udhëzuesit:
1. Merita Shala: Fusha - Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor; Fusha - Qasja ndaj të mësuarit.
2. Mimoza Shahini: Fusha - Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme; Fusha - Zhvillimi social dhe emocional.
3. Alida Thaçi: Fusha - Zhvillimi matematikor; Fusha - Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimi.
4. Adhurim Rasimi: Fusha - Arti dhe muzika.
5. Remzije Krasniqi: Fusha - Gjithpërfshirja.

Shtypi: Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

E drejta autoriale - MASHT

Hyrje

Udhëzuesi praktik për prindër, është i ndërlidhur me udhëzuesin praktik për edukatorë. Ky udhëzues do t'i kontribojë drejtpërsëdrejti zbatimit të dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç. Udhëzuesi u ofrohet prindërve si mbështetje për fëmijët, në përforcimin e njohurive dhe shkathtësive të cilat tashmë i kanë përfituar në kopsht dhe jo vetëm.

Ky udhëzues është vazhdimësi e dokumenteve të cilat në mënyrë hierarkike e ndihmojnë dhe e bëjnë të zbatueshme njëra-tjetrën. Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e vlerave dhe parimeve mbi të cilat është mbështetur dokumenti i SZHMFH-së, si: individualiteti, autonomia, vetëbesimi koncepti pozitiv për veten, zhvillimi i tërësishëm i fëmijëve, zhvillimi i aftësive komunikuese, kreativiteti, respekti dhe dashuria ndaj vendit, përkatësia dhe përgjegjësia sociale.

Parimet bazë mbi të cilat mbështet realizimi i përmbajtjes së dokumentit të standardeve janë: barazia, zhvillimi i gjithanshëm i fëmijës, bashkëpunimi në mes të faktorëve edukativ, loja dhe të mësuarit duke ndërvepruar. Çdo fëmijë është i gatshëm të mësoj nga lindja dhe të jetë pjesëmarrës aktiv.

Përmbajtja e udhëzuesit

Udhëzuesi përmban shembuj praktik të aktiviteteve, duke i ndarë ato në shtatë fusha zhvillimi, modele të aktiviteteve të cilat pritet të realizohen nga prindërit, në ambientin e familjes me fëmijët e tyre për të gjitha fushat e zhvillimit.

Temat e përdorura janë marrë nga planet mujore dhe javore të disa institucioneve parashkollore, të cilat janë ndërlidhur me ambientin e familjes në mënyrë që të përforecohen njohuritë dhe shkathtësitë e fëmijëve të fituara më parë.

Ky udhëzues u dedikohet të gjithë prindërve që kanë fëmijë të moshave 0-6 vjeç.

Përmbajtja

Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor ..... 5 - 10
Qasja ndaj të mësuarit ..... 11 - 16
Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme ..... 17 - 21
Zhvillimi social dhe emocional ..... 22 - 26
Zhvillimi matematikor ..... 27 - 31
Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimi 31-34
Arti dhe muzika ..... 35 - 39

Mosha 0-6 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e aftësive koordinuese të lëvizjeve.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e koordinimit.
- Bebet mësojnë nëpërmjet lojës, natyrisht nëse atyre u jepet liria e duhur, kufijtë, dashuria e pakushtëzuar dhe mjetet e nevojshme.
- Stimuloni, ngacmoni dhe tregojuni fëmijës se si të ndjekë objektet e lëvizshme.

Aktiviteti: Ku shkoi ?
Rezultati i pritur nga aktiviteti: Fëmija tregon interes, duke u përgjigjur me lëvizje të trupit, në disa nga lëvizjet që sheh.
Materialet dhe mjetet: Ambient natyre
Organizimi i aktivitetit:
Merreni fëmijën në krahë dhe dilni jashtë në natyrë, ose rrini pranë një dritareje nga ku mund të shihni degët e pemëve duke lëvizur nga era, zogjë që fluturojnë, njerëz apo makina që lëvizin. Ndiqni disa prej lëvizjeve që shihni dhe ndërkohë bisedoni me fëmijën tuaj për gjithçka që ju shihni. Vëzhgoni me kujdes edhe lëvizjet e trupit të bebës suaj.
Kini parasysh: - Bebet nuk janë prej qelqi....ato kanë nevojë dhe janë të gatshme të eksplorojnë ambientin e ri ku kanë ardhur. Jepuni këtë mundësi. Zhvilloni aktivitete e lojëra të përditshme me ta.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që fëmija të ekspozohet ndaj objekteve në lëvizje. Ju mund të zhvilloni edhe aktivitete të tjera të tilla si: vendosja e bebes përmbys duke stimuluar kështu forcimin e muskujve; ofrimin e lodrave të buta duke ngacmuar kapjen e tyre nga beba; ofrimin e lodrave/materialeve me zhurma ne prekje apo lëvizje të bebes etj. Me rritjen e tyre bebet mësojnë të kontrollojnë pjesë të ndryshme të trupit të tyre. Këto përmirësime ndjekin një model që lëviz nga koka deri te këmbët dhe nga qendra e trupit të tyre drejt gjymtyrëve. Zhvillimi i aktiviteteve apo lojërave të ndryshme me bebet në këtë grupmoshë, nxit dhe siguron një zhvillim më të mirë të tyre.

Mosha 6-18 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e aftësive senso-lëvizore.
- Aktiviteti e ndihmoon fëmijën që të përdor shqisat për të rregulluar lëvizjet.
- Stimuloni, kërkoni nga fëmija që të ecë drej një objekti me ngjyrë apo formë.

Aktiviteti: Gjejmë së bashku
Rezultati i pritur nga aktiviteti: Fëmija mbledh lodrat.
Materialet dhe mjetet: shportë me lodra që kanë tre forma të njëjta, p.sh. kukulla, topa, kutiza/kuba, veshje, veshje kukullash apo çfarëdo materiali tjetër me të cilin fëmija mund të luaj. Aktiviteti mund të kryhet edhe kur duam të rregullojmë ambientin, mjafton që të përfshijmë edhe fëmijën dhe t'i tregojmë qartë se çfarë presim që të bëjë.

Organizimi i aktivitetit:
Prindi i shpërndan materialet nëpër të gjithë ambientin dhe vendos tre shportat në tre vende të ndryshme. Pastaj kërkon nga fëmija që të bëjnë një garë së bashku dhe të mbledhin objektet apo lodrat sipas formës, ngjyrës, butësisë, fortësisë, madhësisë, përdorimit të përbashkët, etj. Prindërit duhet të flasin me fëmijët gjatë aktivitetit, duke e lavdëruar në disa raste e duke e orientuar në disa raste të tjera. Vlerësojeni fëmijën kur plotëson kërkesat e lojës dhe orientojeni atë me shumë dashamirësi, duke e bërë edhe një herë lojën bashkë me të kur këto kërkesa nuk plotësohen.

Qëllimi kryesor i lojës është që fëmija të koordinojë informacionin shqisor me lëvizjet e tij/saj, prandaj përdorni sa më tepër ngacmues shqisor për fëmijën, si të dëgjuarin, të prekurin, të shikuarit, të ndjerit etj.

Kini parasysh:
- Fëmijët kanë nevojë që të kenë udhëzime të qarta për lojën
- luani drejt [fer]
- përdorni lavdërimet kur fëmija plotëson udhëzimet dhe përdorni orientimin ose jepni më tepër sqarime kur fëmija nuk plotëson udhëzimet e dhëna.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kujdesit për veten
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e shkathtësive në plotësimin e rutinës ditore gjatë veshjes dhe ushqyerjes, në zhvillimin e pavarësisë, vetëbesimit.
- Stimuloni, kërkoni nga fëmija që të vishet me pak ndihmë nga ju

Aktiviteti: Shkojmë në shëtitje ose vizitë tek gjyshja
Rezultati i pritur: Fëmija vesh xhupin/jaknen/pantallonat...etj [një veshje] me pak ndihmë
Materialet dhe mjetet: Veshjet e fëmijës (sipas stinës).

Organizimi i aktivitetit:
Ky aktivitet mund të kryhet disa herë. Në fillim kërkojmë që fëmija të veshë një veshje më të madhe sikur jakne apo pallto, e më vonë kërkojmë që të veshë edhe veshje të tjera të tij/saj, të cilat janë më të vogla dhe kërkojnë më tepër koordinim.
Në varësi të kohës, planifikoni bashkë me fëmijën për të bërë një shëtitje apo një vizitë tek gjyshja. Pyetini fëmijët çfarë duhet të veshin, çfarë duan ata të veshin dhe pse? Ju filloni të visheni për veten tuaj dhe kërko që fëmija të gjej veshjen e tij/saj dhe të provojë ta veshë vetë. Vëzhgoje me kujdes. Nëse fëmija ka vështirësi, tregoj se si po e vesh veshjen tënde, tregoj 2 ose tre herë dhe pastaj

kërko që ai/ajo të provojë vetë. Mos u ofroni menjëherë ta vishni fëmijën tuaj, jepini kohë që të provojë disa herë dhe vetëm në rast se ju kërkon ndihmë, ndihmojeni.
Kur të jeni gati të dy ose të gjithë në familje, diskutoni gjatë rrugës për veshjet, pse veshim tani këto veshje dhe si lidhet kjo me kujdesin për vete.

Qëllimi kryesor i aktivitetit, është që fëmija të përforcojë shkathtësitë dhe të bëhet sa më i pavarur në plotësimin e rutinës ditore. Mos prisni që fëmija të bëjë menjëherë atë që ju i udhëzoni apo kërkoni. Fëmijët kanë nevojë për kohë që të mësojnë dhe të përvetësojnë atë çka është e re për ta. Biseda me ta për veshjet, për shëndetin dhe për kujdesin ndaj vetes e lehtëson dhe e zhvillon më tej të kuptuarit e tyre. Nëse ju i jepni mundësi dhe kohë fëmijës të provojë dhe të përpiqet vetë, ju keni bërë më të mirën për të.

Mosha 2-3 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e aftësive lëvizore bazike të fëmijës (muskujt e mëdhenj)
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e ekuilibrit (baraspesha), muskujve të mëdhenj, vëmendjes, sigurisë në vetvete.
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të ecë përmbi një vijë, shteg, (brenda në shtëpi ose jashtë)

Aktiviteti: Ecim nëpër rrugën/shtegun e vizatuar [ose rrugën e breshkës, ose të kërmillit ose të lepurit, etj etj]

Rezultati i pritur: Fëmija ecën në shtegun/rrugën e vizatuar

Materialet dhe mjetet: një shkop, një ngjitës me ngjyrë për të bërë një shteg në dysheme, oborri ose parku ose ambienti shtëpiak, një dhuratë e vogël, materiale që janë në shtëpi për tu përdorur si pengesa.

Organizimi i aktivitetit: brenda në shtëpi ose jashtë në oborr ose në park, bëni një shteg të drejtë ose me disa dredha, ose edhe me gropa e kodrina të vogla në të. Vendosni edhe pengesa të ulëta si p.sh. jastëk, top, kuti kartoni, ndonjë lodër pellushi, kur aktivitetin do ta bëni në shtëpi. Nëse do të dilni në oborr apo në park, zgjedheni shtegun që të ketë edhe pengesa. Udhëzoni fëmijët se si këmba e tyre duhet të jetë mbi shteg, dhe tregojuni që nëse ecin mbi shtegun si duhet, ata do të gjejnë në fund të tij një 'dhuratë'. Ju e përcaktoni se cila do të jetë dhurata. Le të jetë diçka që fëmija e ka me qejf, por jo gjithmonë dhuratë materiale.

Qëllimi kryesor i aktivitetit, është që fëmija të zhvillojë ekuilibrin. Ju mund të krijoni edhe aktivitete të tjera në të cilat ti vendosni fëmijët para 'detyrave' apo sfidave. Fëmijët i pëlqejnë shumë sfidat dhe ata do të angazhohen me shumë qejf në këto detyra. Ju vetëm siguroni që fëmija të mos vritet apo lëndohet, dhe që fëmija të vlerësohet për mundin që ka bërë dhe për rezultatin që ka mbërritur.
Përgëzimet janë shumë të mira për fëmijët nëse bëhen kur fëmija realizon një detyrë apo përmbush me sukses një sfidë.

Mosha 3-4 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e aftësive lëvizore të fëmijës (muskujt e vegjël)
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e koordinimit sy-dorë, në forcimin e muskujve të vegjël, kreativitetin dhe ndjenjën e suksesit.
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të krijojë vetë duke përdorur materiale që i gjen vetë

Aktiviteti: Kopshti im (shtëpiza; pylli; oborri etj)
Rezultati i pritur: Fëmija gjen materialet dhe krijon oborrin ose shtëpizën ose kopshtin e tij/saj.

Materialet dhe mjetet: një top brumi, çdo gjë që fëmija e gjen në shtëpi ose në oborr dhe që mendon se i duhet.

Organizimi i aktivitetit: Të gjitha kemi mundësi të bëjmë një top brumi në shtëpi. Më e mira është që këtë top ta bëjmë bashkë me fëmijën.

Kërkoni nga fëmija që të ndërtojë vetë një pyll, ose një park, ose një kopsht zoologjik, ose një kopsht botanik, ose një shtëpi për qenushin, ose çfarë dëshiron ai/ajo vetë të ndërtojë. Udhëzojeni që të gjej materialet që i duhen [gjethe, shkopinj, tasa bosh në shtëpi, makarona, gurë të vegjël... ..etj]

Qëndrojini pranë duke e vëzhguar, por mos bëni asgjë që ai /ajo mund ta bëjë vetë. Lejojeni vetë fëmijën të ndërtojë ashtu si dëshiron dhe si di. Ju përgëzojeni gjatë dhe pas mbarimit të punës, dhe bëhuni kurioz t'ju tregojë çfarë ka bërë dhe pse.

Nëse dëshironi që fëmija juaj të shkruajë me lehtësi dhe bukur në shkollë, të lexojë pa vështirësi dhe rrjedhshëm, të jetë i suksesshëm në sporte të ndryshme dhe të fitojë më tepër pavarësi në aktivitetet e tij/saj të përditshëm, atëherë stimulojeni që të bëjë aktivitete që zhvillojnë koordinimin sy-dorë.

Mosha 4-5 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e aftësive lëvizore fine të fëmijës (muskujt e vegjël)
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e aftësive të përdorimit të duarve dhe gishtave
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të bëjë çfarë të dojë me një material të sigurtë

Aktiviteti: i lirë
Rezultati i pritur: Fëmija luan me materialin dhe krijon me të çfarë të dojë
Materialet dhe mjetet: Gjithçka e butë, e pastër dhe e sigurtë që e lejon fëmijën të luajë me të dhe e të bëjë forma të ndryshme.

Organizimi i aktivitetit:
E/I dashur prind! Zgjidh cilindo material që dëshiron [më e mira do të ishte po ta zgjidhte vetë fëmija], megjithatë mblidhe mendjen...vajza ose djali yt sot ka nevojë të ndjejë nëpër gishta butësinë, rrëshqitshmërinë, lagështinë, fortësinë, densitetin e njërit prej këtyre materialeve. Përfitimet që do të ketë nga një lojë e tillë janë shumë herë më të mëdha se sa 'belajat' që do të mund të bëjë.
-Vishini fëmijëve rroba jo shumë të reja [ose 'futi' në një qese plastike të hollë
-Siguro që materiali të mos përmbajë asgjë të rrezikshme
-Luaj bashkë me të
-Sigurohu që përdor sa më tëpër shqisa gjatë lojës
-Komuniko me të gjatë lojës
-Bëni një garë së bashku
-Kënaquni

Muskujt e vegjël të fëmijëve e mbërrijnë pjekurinë e tyre në moshën tetë vjeçare. Fëmijët kanë nevojë të kenë sa më tepër aktivitete që stimulojnë këtë zhvillim me qëllim që ta kenë më të lehtë kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme si: prerja, veshja, detyrat e kujdesit për vetenl etj. Pa aftësinë për të përfunduar këto detyra çdo ditë, ata rrezikojnë suksesin në shkollë dhe vetë-vlerësimi i tyre është i ulët. Ndihmojeni fëmijën tuaj që përmes aktiviteteve, lojrave të shumllojshme të forcojnë vetëbesimin dhe vetërespektin dhe të jenë të gatshëm për shkollë.

Mosha 5-6 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e shkathtësive në ruajtjen e shëndetit
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e kujdesit ndaj vetes, e bën atë më të pavarur, ndihmon arsyetimin, vetëbesimin dhe komunikimin.
- Udhëzoni, kërkoni që fëmija të kujdeset për pastërtinë e ushqimeve që përdor.

Aktiviteti synon që të rrisë gatishmërinë e fëmijës për shkollë. Një fëmijë i shëndetshëm është një fëmijë që mëson më shpejt dhe më mirë.

Aktiviteti: Nga tregu në stomak

Rezultati i pritur: Fëmija zgjedh, mban, pastron, diskuton për frutat ose perimet që pëlqen dhe që nuk i pëlqen

Materialet dhe mjetet: Tregu i gjelbër ose supermarketi

Organizimi i aktivitetit:
Shkuarja bashkë me fëmijën në treg ose supermarket, mund të kthehet në një aktivitet të mrekullueshëm edukativ.
Uluni bashkë me fëmijën dhe bëni listën e gjërave që do të blini [pyeteni çka i pëlqen, çka nuk i pëlqen dhe pse]. Më pas kërkoni që fëmija të bëhet gati vetë dhe shkoni në treg. Lejojeni duke e mbikëqyrur që të zgjedh disa prej gjërave që do të blini, përfshijeni edhe në diskutimin për çmimet apo lejojeni që ta bëjë ai/ajo pagesën. Jepini t'i mbajë vetë qeset me frutat ose perimet që i pëlqejnë apo që ka zgjedhur vetë. Në shtëpi, lejojeni të pastrojë frutat që dëshiron t'i hajë dhe pyeteni çfarë mund të ndodhë nëse nuk i pastron. Pyeteni edhe pse nuk i pëlqejnë disa perime dhe çfarë ndodh me trupin tonë nëse nuk i hamë. Mos gjykoni atë çka thotë fëmija, përpiquni të sqaroni apo të jepni sa më shumë arsye për të mbështetur mendimin tuaj. Mos prisni që vetëm një bisedë apo vetëm ky aktivitet do të mjaftojë.

Kini parasysh:
- Shprehitë e mira krijohen vetëm duke e angazhuar fëmijën në aktivitete të shumta e të shpeshta të përitshmërisë.
- Ju jeni modeli i tij/saj. Aktivitetet bëni bashkë si pjesë e rutinës suaj ditore, jepini modelin tuaj dhe përgëzoni fëmijën në atë që bën.

Aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijën në zhvillimin e aftësive fizike dhe lëvizore

- Ndërtimi me kuba (blloqe)
- Ngjyrosje me shkumësa
- Hedhja e gjësendeve, objekteve apo ujit në enë me përmsa të ndryshme
- Hapja dhe mbyllja e kutive apo objekteve
- Shtrydhja e sfungjerëve të lagët, hapja dhe mbyllja e një tapë shisheje
- Grisja e letrave në copa të vogla duke shfrytëzuar gishtat
- Loja me puzzle (sajuese), vendosja e një objekti në vendin e vet
- Imitimi (nga prindt apo kujdestari) e zhgarravinave në fletë
- Veshja dhe zhveshja e kukullave me rroba me zingjir, kopsa dhe lidhëse
- Modelim me material të butë si plastelina, brumi apo argjila
- Vizatimi i dorës së tij/saj apo edhe të prindit
- Lojë me gishta- prek gishtin e madh me të gjithë gishtat e tjerë të të njëjtës dorë
- Vizatimet apo figurat i ngjet me fara të vogla apo objekte të vogla
- Prerja e materialeve të ndryshme si letër, shtof, faculetë etj.
- Lidhja e objekteve të ndryshme në nyje apo formë tjetër
- Angazhimi i fëmijës në lojëra me gishta, këngë, veprimtari ritmike që përfshijnë lëvizje, imitime fytyrash, kafshësh etj.

Qasja ndaj të mësuarit

Mosha 0-6 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën të mësojë përmes eksperiencave.
- Aktiviteti e stimulon fëmijën që të kërkojë në vazhdimësi dhe të mësojë përmes asaj që bën.
- Bebet janë të gatshme që të mësojnë që në momentin që vijnë në jetë.
- Ato mësojnë më së miri përmes eskperiencave personale të tyre.
- Stimuloni fëmijën që të ketë sa më tepër eksperienca dhe përforconi të mësuarit e tyre.

Aktiviteti: Shprehjet e fytyrës

Rezultati i pritur nga aktiviteti: Fëmija i përgjigjet shprehjes së fytyrës së prindit duke e imituar.

Organizimi i aktivitetit:
Shumë gjëra ndodhin gjatë muajve të parë të fëmijës tuaj. Fëmija juaj do të fillojë zhvillimin e tij/saj duke mësuar të përqëndrojë shikimin e tij/saj; do të fillojë duke iu përgjigjur thirrjes së emrit dhe zërit tuaj, dhe do të mësojnë lëvizjet e mëdha dhe të vogla të trupit. Se sa mirë do të

zhvillohet, kjo varet nga ju, nga mundësitë që ju i jepni që ai/ajo të përjetojë e të mësojë nga çdo gjë që bën. Kjo duhet bërë çdo ditë. Vendoseni fëmijën përballë vetës dhe bëni një shprehje në fytyrën tuaj (buzëqeshje, habi, etj, etj) të cilën e përsëritni disa herë. Mos prisni që fëmija t'ju imitojë menjëherë dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Përsëriteni ditë pas dite dhe do të shihni që fëmija do të mësojë t'ju imitojë.

Sa më tepër stimuj të ketë fëmija, aq më tepër ai do të angazhohet e aq më shumë ai/ajo do të zhvillohet. Fëmijët janë në mënyrë perfekte të gatshëm për tu marrë me stimujt që ju i ofroni.

Mosha 6-18 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e imagjinatës dhe kreativitetit
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën që të zhvillojë kreativitetin dhe imagjinatën, të provojë disa herë, të mësojë gjëra të reja.
- Në këtë moshë, fëmijët tashmë e kanë eksploruar ambientin që i rrethon mjaft mirë dhe tani ata shohin mundësi të lojës në gjithçka...mos u çuditni nëse fëmija juaj e kthen karrotën në një anije kozmike apo gotën në kapele. Stimuloni kreativitetin dhe imagjinatën e fëmijës në përdorimin e materialeve që i ofroni.

Studimet kanë treguar që fëmijët me imagjinatë të zhvilluar bëhen fëmijë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Shfrytëzoni materialet që keni në familje për t'i kthyer ato në ngacmues të imagjinatës së fëmijëve. Këtë bëjeni çdo ditë...

Aktiviteti: Çfarë mund të bëhet me këto gjëra?
Rezultati i pritur nga aktiviteti: Fëmija shfrytëzon materialet e dhëna apo lodrat apo objektet e sigurta për të krijuar.
Materialet dhe mjetet: rërë, ujë, kos, baltë, plastelinë, brumë, pambuk, dhe ose ngjyra.

Organizimi i aktivitetit:
Në këtë moshë, fëmijët e pëlqejnë shumë lojën. Krijoni një ambient të sigurtë ku fëmija nuk mund të lëndohet dhe ofrojini materialet. Lejojeni që të krijojë me to çfarë do ai/ajo. Vëzhgojeni me kujdes reagimin e tij/saj gjatë përzierjeve që bën. Stimulojeni që t'i bëjë sërish disa përzierje. Përgëzojeni dhe kënaquni bashkë me të dhe me krijimin e tij/saj.

Keni parasysh:
- Ju mund ta zhvilloni më tej kreativitetin dhe imagjinatën e fëmijës duke u bërë interaktiv me të.
- Përdorni lavdërimet ose orientoni disa veprime të fëmijës që e bëjnë atë të mendojë rreth tyre

Mosha 18-24 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën të marrë pjesë në disa aktivitete, veprimtari dhe të këmbëngulë edhe kur përballet me pengesa apo vështirësi
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e këmbënguljes, zgjidhjes së problemeve, vetëbesimit, vetërespektit
- Stimuloni, kërkoni nga fëmija që të zgjidhë vetë një situatë loje

Aktiviteti: Bartja e makaronave, smokave etj...
Rezultati i pritur: Fëmija përdor një masë për të bartur makaronat nga një tas tek tjetri
Materialet dhe mjetet: Një tas me makarona, një tas bosh dhe një gotë, ose një garuzhde, ose një kullojse [çfarëdo mjeti i sigurt dhe i pastër që shërben për të bartur makaronat]

Organizimi i aktivitetit: Në ambientin e shtëpisë, siguroni dy tasa si në figurë dhe udhëzoni fëmijën tuaj që të bëjë bartjen e makaronave nga një tas në tjetrin. Si fillim mos i jepni asnje mjet bartës, lëreni të provojë ashtu si ai mendon se do t'i bartë makaronat. Vëzhgoni përpjekjet e tij/saj dhe pyeteni se mos ka nevojë për ndonjë gjë ose për ndihmën tuaj. Më pas ofrojini një gotë, ose garuzhde ose një kullojsë ose një lopatë të vogël lodre dhe pyeteni se si mund ta përdorë. Përgëzojeni për tentativat që bën, ofroni udhëzime aty ku e shihni të arsyeshme por vetëm nëse e shihni që janë të nevojshme. Jepi kohë të përpiqet vetë për të zgjidhur situatën.

Qëllimi kryesor i aktivitetit, është që fëmija të ballafaqohet me një situatë në të cilën ka vështirësi dhe të përpiqet të gjej rrugë dhe mënyra të ndryshme për të zgjidhur vetë këtë situatë. Qëndroni afër tij/saj dhe përgëzojeni kur arrin ta kryejë si duhet bartjen.

Mosha 2-3 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e interesit dhe kuriozitetit për të mësuar gjëra të reja.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e interesit dhe kuriozitetit për të mësuar për gjërat e reja, në stimulimin e të menduarit, në zhvillimin e komunikimit, zgjidhjes së problemeve etj.
- Lexojini osë tregojini fëmijës të paktën tre herë në javë përralla, tregime, histori ngjarje të ndryshme. Shikoni bashkë me fëmijën një emision për fëmijë dhe diskutojeni së bashku.

Aktiviteti: Cili është tregimi i radhës....
Rezultati i pritur: Fëmija e plotëson [vazhdon aty ku ka ngelur] tregimin, ngjarjen, përrallën, historinë...
Materialet dhe mjetet: libër me figura, libër me përralla, televizori, DVD nëse dëshironi, CD, etj,
Organizimi i aktivitetit: Të lexuarit, të parit, të dëgjuarit, të treguarit fëmijëve dhe bashkë me fëmijët është një nga aktivitetet që pëlqehet shumë nga fëmijët dhe nga të cilët fëmija përfiton shumë.

Krijoni në shtëpi këndin tuaj të përbashkët të leximit.

Provoni të vendosni në të disa libra që i bleni bashkë me fëmijën, ose që i zgjidhni bashkë me fëmijën nga librat që keni në shtëpi. Bëjani me dije se ajo është biblioteka e tij/saj. Mos u merakosni nëse në të si fillim ka vetëm 2 ose 3 libra.
Përcaktoni bashkë me fëmijën një orar për të lexuarit tuaj dhe diskutoni bashkë se çfarë do të lexoni apo tregoni apo dëgjoni apo shihni sot.

Lexoni me ngadalë dhe qartë fillimin e tregimit ose përrallës. Aty ku ju mendoni, ndaloni dhe kërkoni nga fëmija t'ju tregojë se si do të vazhdojë përralla, ose si do të kishte vepruar fëmija juaj. Lejojeni të shprehet ashtu si ai/ajo mendon pa e gjykuar, pa e ndërprerë. Vazhdoni sërish të lexoni, në vendet ku ka figura kërkoni që fëmija të 'lexojë' figurën. Lejojeni që ta përmbyllë fëmija storien. Pastaj ju lexoni si e ka përmbyllur autori.

Qëllimi kryesor i aktivitetit, është që fëmija të stimulohet, nxitet duke dëgjuar ose duke parë që të zhvillojë interesin dhe kuriozitetin e tij/saj për gjithçka rreth tij/saj. Fëmijët kanë nevojë për të qenë pjesë e situatave duke i përjetuar vetë ato, vetëm kështu ata do të mësojnë dhe do të zhvillohen më së miri.

Mosha 3-4 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e iniciativës në veprimtarinë e fëmijës
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e iniciativës, pavarësisë, vetëbesimit, zgjidhjes së problemeve, këmbëngulje, vetëvlerësimit dhe të mësuarit.
- Pavrësisht motit, është shumë e rekomandueshme që fëmijët të kalojnë të paktën 30 minuta lojë jashtë në natyrë. Krijojeni këtë mundësi për fëmijën duke i udhëzuar, stimuluar që të bëjë vetë përcaktimin e aktiviteteve që do të bëjë apo të materialeve dhe lodrave që do të përdori në lojërat e veta.

Aktiviteti: Unë përcaktoj lojën.
Rezultati i pritur: Fëmija përcakton çfarë loje do të bëjë ose çfarë materialesh do të përdorë për atë lojë.
Materialet dhe mjetet: Të gjitha ato që mund të konsiderohen lodra dhe materiale të sigurta e të pastra për fëmijët, me të cilët fëmija mund të luajë jashtë në natyrë.

Organizimi i aktivitetit:
Mesiguri që secili prej prindërve ka në shtëpi një shportë, ose një qese ku mban lodrat e fëmijës. Por meqenëse fëmijët kanë shumë dëshirë të luajnë jashtë në natyrë, është shumë e rekomandueshme që të bëni edhe kutinë e tij/saj të lodrave për jashtë. Ju mjafton një kuti kartoni e madhe dhe lejojeni fëmijën të hedhë në të, të gjitha ato që fëmija i konsideron lodra [ju vetëm siguroni që të jenë të sigurta]. Lejojeni fëmijën që të përcaktojë çfarë do të luajë sot dhe cilat lodra do të përdori në lojën e vet. Bëhuni edhe ju pjesë e lojës dhe komunikoni me të duke e përgëzuar apo kërkuar udhëzime prej tij.

Nëse e lejoni fëmijën të zgjedhë vetë lojën e tij/saj, të përcaktojë vetë çfarë dëshiron të luajë, të zgjedhë vetë çfarë dëshiron të veshë [edhe pse mund të mos ju pëlqejë juve] ju po kontriboni shumë që ai të bëhet një individ me iniciativë, vetë besim dhe i gatshëm për të mësuar marjen e përgjegjësive mbi vete. Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmija të zhvillojë iniciativën dhe mendimin e pavarur, të mësojë të bëjë zgjedhje dhe të kuptojë lidhjet shkak-pasojë.

Mosha 4-5 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e këmbënguljes tek fëmijët
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e shkathtësive për jetë, në zhvillimin e këmbënguljes, në zhvillimin e vetëbesimit, në zgjidhjen e situatave dhe të menduarit.
- Fëmijët janë kuriozë nga natyra dhe eksplorimi është pasioni i tyre.
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të jetë pjesë aktive dhe të përfshihet në aktivitete deri në realizimin e tyre.

Aktiviteti: Gjej ku janë
Rezultati i pritur: Fëmija gjen atë që kërkon ose që i kërkohet.
Materialet dhe mjetet: Çdo gjë e sigurt që e lejon fëmijën të luajë me të.
Organizimi i aktivitetit:
Loja 'gjej ku janë' mund të planifikohet paraprakisht apo mund të shpiket aty për aty. Angazhojeni fëmijën tuaj në një mision argëtues për të gjetur artikuj në shtëpi, oborr, supermarket, park etj.

- Nëse jeni në supermarket, kërkoni nga fëmija të gjej ushqime që janë të një ngjyre të veçantë (e verdhë, jeshile, blu...) apo të kërkojë për objekte të një formë si një rreth, katror, trekëndësh etj. Nëse fëmija juaj ka nevojë për ndihmë, zgjidhni ju një objekt dhe orientojeni fëmijën në të kuptuarit e tij. "Cili objekt është i kuq? Cili objekt është një rreth?"
- Të njëjtin aktivitet mund ta zhvilloni edhe në shtëpi për artikuj të ndryshëm të etiketuar, ose i kërkoni atij/asaj për të kërkuar në rafte librash për një libër të veçantë në ngjyrë apo madhësi. Ju mund të pretendoni se nuk po e gjeni dot bluzën e tij/saj ngjyrë portokalli ose një palë çorape, ose një lodër, ose një vegël, ose një zarf, ose një.....çfarëdo.

- Zhvillimi i këmbënguljes tek fëmijët është shumë i rëndësishëm në këtë moshë.
- Fëmija mëson të jetë këmbëngulës jo duke i thënë por duke e lejuar dhe stimuluar që të këmbëngulë në situata të lojës apo të rutinës së përditshme.
- Përgëzimi për arritjen apo realizmin e kërkesës e ndihmon fëmijën të kuptojë që vështirësitë kapërcehen dhe ka zgjidhje.

Mosha 5-6 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e imagjinatës dhe kreativitetit.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e kujdesit ndaj vetes.

Në moshën 5-6 vjeç, koordinimi dhe aftësinë për të përdorë duart zhvillohen gati plotësisht, duke e bërë më të lehtë për fëmijën tuaj që të shprehë mendimet dhe idetë dhe për të bërë forma komplekse të tilla si diamante, trekëndësha, yje etj. Imgjinata e tij/saj në këtë kohë është ende e bujshme. Rreth kësaj kohe, fëmija juaj mund të fillojë të përdori edhe artin për të ndihmuar për të treguar histori dhe për të treguar ngjarje dhe emocione. Udhëzoni, stimuloni, nxitni, kërkoni.

Aktiviteti: Luajmë me veshje

Aktiviteti synon që gjallërojë imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijës, të krijojë mundësi për të shprehur emocionet dhe ndjenjat.

Rezultati i pritur: Fëmija visheet si personazhi që zgjedh
Materialet dhe mjetet: Veshje të vjetra të anëtarëve të shtëpisë
Organizimi i aktivitetit:
- Të gjithë ne kemi veshje të vjetra në shtëpi, bluza, xhampere, fustane, këpucë, kapele, shall, doreza, pantallona, etj., etj., të cilat mund të kthehen shumë mirë në lodra për fëmijët. Lejojeni fëmijën të zgjedhë çkado që dëshiron nga veshjet e vjetra dhe ndiqeni në lojën e personazheve që ai/ajo zgjedh. Vishuni edhe ju bashkë me fëmijën në ndonjë prej personazheve që ai bën...

Aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijën në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të jetës së përditshme

- Përkrahni fëmijën për të identifikuar emocionet e veta (p.sh. "Unë jam i gëzuar sepse...." ose "unë po qaj sepse...."
- Bashkëbisedoni dhe nxiteni fëmijën të shpreh ndjenjat e tij/saj (p.sh. pas një feste, pas një grindje, etj.)
- Diskutoni se si duhet të sillemi në situata të ndryshme
- Përdorni përrallat, tregimet për të ndihmuar fëmijët të marrin në konsideratë ndjenjat e të tjerëve
- Inkurajoni fëmijën të jap ndihmë apo të ndajë lodrat me fëmijët tjerë
- Mundohuni të mos i qëndroni fëmijës tuaj prapa duke e kontrolluar, lejoni fëmijën të ketë argëtim. Ju mund ta ndihmoni apo ndërhyni vetëm nëse fëmija juaj ka nevojë për të
- Lavdërojeni fëmijën si për përpjekjet ashtu edhe për arritjet (e di që kjo është e vështirë për ty, por e ke nisur mirë)
- Bëjini lavdërimet specifike dhe të çiltra (tregojini fëmijës qartësisht përse jeni i kënaqur me të (më pëlqeu shumë se si u përpoqe t'i veshësh vetë këpucët)
- Mësojeni të flas pozitivisht për veten. Duke e inkurajuar fëmijën të verbalizojë gjërat e mira që bën, ju do t'a ndihmoni në zhvillimin e një imazhi pozitiv për veten dhe në rritjen e vetëvlerësimit, p.sh. "unë jam bërë shumë i zoti për të mbërthyer vetë zingjirin"
- Përdorni shpërblimet për sjelljet dhe veprimet e mira, këto mund të jenë (përqafimet, buzëqeshjet e fytyrat e qeshura, fjalët e mira dhe inkurajuese deri te koha e veçantë e kaluar me fëmijën)
- Tregoni mos aprovim për sjellje jo të duhur, (psh. kur e qëllon Gentin me shkelm atij i dhemb dhe mërzitet shumë, gjithashtu më mërzit edhe mua. Unë e di që Gentit i pëlqen të luaj me ty dhe ju luani zakonisht shumë mirë së bashku).

LOJËRA TË NDRYSHME QË MUND T'I ZHVILLONI ME FËMIJË

Loja e Kimit - vendosni tre-gjashtë sende (letra me ngjyrë, blloqe, lapsa me ngjyra etj.) në një tavolinë dhe kërkojini fëmijës t'i shikojë ato. Hiqeni njërin nga këto sende ndërsa fëmija mbyll sytë dhe kërkoni që të thotë emrin e sendit që mungon. Si alternativë mund t'i mbuloni sendet dhe t'a pyesni fëmijën nëse i mban mend të gjitha.

Kështjella me ngjyra - vendsni tre ose më shumë toptha letre brenda një tubi (tubi prej kartoni i letrave të kuzhinës), shikoni nëse fëmija arrin të mbajë mend rendin dhe ta kopjojë në tubin e tij.

Më kopjo - bëni një veprim, p.sh. duartrokitni ose kërceni. Kërkoni fëmijës që të kopjojë atë që bëtë ju. Shtoni një veprim tjetër dhe shikoni nëse fëmija mundet t'a kopjojë.

Kukulla me qese letre- përdorni qese të vogla letre që të futen lirshëm në dorën e fëmijës. Tregoni fëmijës se si të fusin dorën Brenda dhe me gishtat e tyre të hapin dhe mbyllin palosjen. Fëmijët mund të përdorin materiale me ngjitës që të vendosin në kukull (sytë, gojën, flokët, etj.) për të krijuar pamjen e kukullës.

Dordolec me çorape- çorapet e vjetra të bardhë bëhen dordolec të mrekullueshm. Mbushni çorapen me material si p.sh.(oriz, kokërra kafeje apo misër) dhe mbylleni me një lidhëse gome, pastaj edhe në mesin e çorapes e vendosni një lidhëse gome dhe formësojeni çorapen e mbushur si një dordolec të cilën mund ta dekoroni me lapsa me ngjyrë fytyrën, trupin, etj.

Pantomimat- pantomimaështë një lloj drame spontane ku fëmijët përdorin gjeste dhe lëvizje, asnjëherë fjalë, tinguj apo veprime. Pantomima i ndihmon fëmijët të ndjenjë trupin rehat, duke qenë se ajo fillon me një përjetim fizik duke bërë koncepte të ndryshme konkrete. Fëmijët e vegjël kanë nevojë për ndihmë/ nxitje që të fillojnë të interpretojnë pantomimën, p.sh. notimi si peshk, fluturimi si zog, mbledhja e luleve, etj.

Mosha 6-18 muaj

- Prindi ndihmon fëmijën të njohë mjedisin përreth
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të ndërtojë kuptimet e para mbi mjedisin, duke përdorur shqisat.
- Fëmija arrinë të identifikojë dhe emërtojë elementë të mjedisit.

Aktiviteti: Prekim dhe shijojmë së bashku.
Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmijës i krijohet mundësia të shikojë, shtërngojë, luaj dhe provojë objekte nga mjedisi.
Materialet dhe mjetet:
Për këtë aktivitet mund të përdoren lodra apo objekte të cilat fëmija mund t'i mbajë në dorë me lehtësi. Femijës mund t'i ofrohen rake - take, goma për dhëmbë, kur është më i madh mund t'i ofrohen materiale me aromë (lule, parfum, paloma me aromë, ngjyra etj.), apo objekte të tjera nga shtëpia apo mjedisi jashtë shtëpisë (në varësi ku mendon prindi ta zhvillojë aktivitetin).
Organizimi i aktivitetit:
Fillimisht prindi i ofron fëmijës objekte të cilat ai mund ti kapë nga pozicione të ndryshme të trupit, kur fëmija është shtrirë në shpinë, bark apo anash. Zakonisht kur aktiviteti është për fëmijët 6-12 muaj, nuk duhet të jetë i gjatë pasi fëmija nuk mund të koncentrohet për një kohë të gjatë. Pastaj fëmiu ndihmohet që të kalojë objektet nga njëra dorë në tjetrën. Prindi mund t'i ofroj fëmijës tek fytyra objekte të cilat stimulojnë shqisën e të pamurit (foto portret, pasqyrë, objekte me ngjyra etj.), objekte që lëshojnë tinguj (zilë, fyell), por këtë herë nga një pozicion që fëmiu nuk e sheh, dhe vështroni reagimin e fëmijës. Ndërkohë që ofroni objekte të ndryshme, vëzhgoni me kujdes cilat janë objektet të cilat fëmijës i pëlqejn më së shumti. Kur fëmija është më i madh objektet i jepen në dorë dhe i duhet dhënë kohë që t'i vëzhgojë në mënyrën e tij. Kur fëmija fut objekte në gojë shoqërojeni me zë veprimin e tij/saj, p.sh. 'oh ju sapo provuat rake taken!' 'oh po mban në dorë arushin!' etj.
Nëse fëmija është më i madh ndërsa është duke i merrë erë objekteve pyeteni: 'çfarë erë mban?' 'çfarë shije ka?' (kur jeni duke i ofruar fruta apo biskota apo ndonjë produkt të natyrës).

Gjatë aktivitetit prindi duhet të vëzhgojë me vëmëndje interesat e fëmijës dhe nuk duhet t'i ofroj fëmijës objekte të cilt janë jo të shëndetshme, të rrezikshme (p.sh. pjesë të vogla të cilat mund të gëlltiten nga fëmija apo lodra që mund të zbërthehen në pjesë të vogla). Duke lejuar fëmijën që të prekë, shtërngojë , nuhasë apo shijojë objekte apo produkte të ndryshme të mjedisit, fëmija krijon njohje më të konsoliduar mbi mjedist që e rrethon.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi ndihmon fëmijën në procesin e të menduarit dhe llogjikës.
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të hulumtojë dhe zbulojë forma të ndryshme
- Fëmija arrinë të manipulojë me material të ndryshëm

Aktiviteti: Krijimi i formave prej plasteline.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija arrinë të imitojë prindin apo fëmijët e tjerë.
Materialet dhe mjetet:
Tavolinë apo vend i rrafshët ku fëmija mund të luaj lirshëm, plastelinë, gota, pipa me ngjyra, pjata plastike, forma te ndryshme gatimi apo krijuar nga prindi me materiale të ndryshme. Plastelina mund të krijohet në mënyrë natyrale, prej mielli, kripe dhe vaji, në rastet kur nuk blihet.

Gjatë aktivitetit prindi duhet të vëzhgojë me vëmëndje interesat e fëmijës dhe nuk duhet t'i ofroj fëmijës objekte të cilat janë jo të shëndetshme, të rrezikshme (p.sh. pjesë të vogla të cilat mund të gëlltiten nga fëmija apo lodra që mund të zbërthehen në pjesë të vogla).
Nga mosha 18 muaj deri në dy vjet, fëmijët fillojnë të luajnë së bashku me fëmijët e tjerë, pa ndonjë ndërveprim. Kjo quhet lojë paralele. Loja paralele i jep mundësi fëmijës të shikojë fëmijët e tjerë, në këtë rast prindin dhe të luaj të njëjtin rol si bashkëmoshatari apo prindi. Ajo gjithashtu ndihmon fëmijën të fitojë kuptimin e idesë të së drejtës së pronës si: "e imja."

Organizimi i aktivitetit:
Në një tavolinë vendosen objekte si pjata, gota plastike me ngjyrë, kafshë të vogla, plastelinë, si dhe forma të ndryshme ku fëmija mund të përgatisë fruta apo forma të ndryshme për gatim. Fëmija lihet i lirë të kryej aktivitetin sipas mënyrës së tij. Ndërkohë është e rëndësishme që prindi t'i bashkangjitet aktivitetit duke përgatitur forma vetë, në mënyrë që fëmija ta imitojë atë. Ky aktivitet mund të zhvillohet duke përfshirë dhe fëmijë të tjerë në familje. Gjatë kryerjes së aktivitetit jepni fëmijës mundësi të zgjedh, p.sh. i ofroni dy pjata me ngjyra të ndryshme dhe pyeteni "dëshiron të kuqen apo të verdhën", "dëshiron të madhen apo të voglën". Lejoni fëmijën të vendos, pavarësisht a i njeh apo jo ngjyrat apo madhësinë. Ndërkohë prindi shoqëron veprimet duke përdorur numrat p.sh. bëra dy mollë, bëra tre rrathë etj.

Mosha 2-3 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën që të përshkruajë veprimet e rutinës ditore
- Aktiviteti inkurajon fëmijën të mbledh informata për ambientin nëpër-mjet vëzhgimit dhe imitimit të prindit.
- Fëmija shpreh interesim për të identifikuar dhe të marrë pjesë në veprime të ndryshme.

Aktiviteti: Domethënia e veprimeve.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija arrinë të imitojë prindin apo familjarët.
Materialet dhe mjetet: Libër me ilustrime.

Organizimi i aktivitetit:
Prindi duhet të përdor rutinën ditore për t'i mësuar fëmijës domethënien e fjalëve që tregojnë veprim. Prindi duhet të zgjedh libra të cilat kanë për ilustrim aktivitete të ndryshme ditore. Prindi, gjatë leximit të librit me fotografi ilustruese,

tregimin e shoqëron me vendosjen e gishtit në fotografi dhe me zë tregon veprimin dhe e imiton atë. Më pas kërkon nga fëmija të bëj të njëjtin veprim. P.sh. prindi thot me zë veprimin dhe kërkon nga fëmiu të vendos gishtin në fotografi, p.sh."Djali po fle. Ai është i lodhur". Prekeni fotografin e djalit në gjumë. "Vajza po pi". "Unë po pi gjithashtu". "A dëshironi të pini" (bëni sikur jeni duke pirë nga një gotë imagjinare).
Ky aktivitet mund të zhvillohet edhe në formën e aktrimit, ku fëmija dhe prindi krijojnë situatë ditore, të cilën fëmija e përshkruan me fjalët e tij/saj. Në aktivitet mund të përfshihen dhe anëtarë të tjerë të familjes.

Në këtë moshë femija ka dëshirë të jetë në qendër të vëmenjes, dhe fillon të thotë "Jo". Gjithashtu, kanë dëshirë t'i kenë lodrat rrëmujë dhe tregojnë emocione të ndryshme.

Mosha 3-4 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën në procesin e të menduarit dhe logjikës.
- Aktiviteti inkurajon fëmijën të përdor materiale të ndryshme në mënyra të ndryshme
- Fëmija arrinë të manipulojë me material të ndryshëm

Aktiviteti: Kolazh mbi natyrën.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija arrinë të imitojë prindin apo fëmijët e tjerë

Materialet dhe mjetet:
Marker, ngjitës, materiale nga natyra (gjethe, kërcell lule, degë peme, bari, guacka etj), një hamer apo sipërfaqe e sheshtë ku mund të vendosen materialet e mbledhura (bez i bardh, apo dërrasë etj.)

Organizimi i aktivitetit:
Fillimisht prindi me fëmijën në shtëpi pregatisin zarfe prej letre me qëllim që në secilin të vendosin shënimin e një ngjyre me marker(p.sh. me marker ngjyrë të kaltër shkruhet mbi zarf "e kaltër", shkrimi duhet të jetë i theksuar që të identifikohet lehtë nga fëmija). Fëmijës i shpjegohet se do të dalin në natyrë për të mbledhur materiale të ndryshme të cilat janë në të njëjtën ngjyrë me zarfet. Fëmija inkurajohet që të mbledhë sa më shumë materiale dhe ftohet që ato t'i fuse në zarf sipas ngjyrës (p.sh. gjethja e gjelbërt hyn në zarfin "e gjelbër"). Prindi mund t'i shpjegojë fëmijës se si të ngjisë zarfin dhe ta inkurajojë që ta bëj vetë. Kur ktheheni në shtëpi, fëmija inkurajohet që të fillojë të ngjisë materialet e mbledhura në hamer apo hapsirën e përzgjedhur nga prindi. Prindi duhet të lejojë fëmijën që ti vendos objektet sipas mënyrës së tij/saj dhe të asistojë nëse fëmiu kërkon ndihmë. Në fund mund t'i vendos kolazhit emrin e fëmiut, p.sh. "Kolazhi i Deonit". Gjithashtu ky aktivitet mund të zhvillohet me forma të ndryshme të përgatitura me bez me ngjyra, letra me ngjyra apo materiale që janë në dispozicion të prindit.

Një lojë e tillë e ndihmon fëmijën të arrijë të krijojë gjëra. Që në foshnjëri fëmija vendos gjëra në gojë duke krijuar ide mbi aromat, shijet, fortësine etj. Këto janë lëvizjet e para që fëmija i përdor më vonë kur të rritet për të ndërtuar me blloqe, luajtur në rërë, apo vizatuar. Kur është duke ndërtuar, me dru, baltë, rërë, plastelinë, apo materiale të tjera, fëmiu vëzhgon dhe shqyrton objektet, duke zbuluar vetë mënyrën si funksionojnë ato. Fëmja duke prekur me dorën e tij gjësendet kriojn ide të reja mbi punën.

Mosha 4-5 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën në procesin e njohjes së fenomeneve që ndodhin në botën bimore.
- Aktiviteti ndihmon fëmijën të kuptojë proceset e rritjes së bimëve dhe dobitë e tyre.
- Fëmija arrinë të tregojë apo përshkruajë natyrën e gjallë, përkatësisht botën bimore.

Aktiviteti: Sera.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija jo vetëm që kupton çfarë është sera dhe krijon një eksperiencë të re, gjithashtu është në gjendje të arrijë në përfundime që bazohen në krahasimin e objekteve.
Materialet dhe mjetet: Qese plastike, dy termometra, laps dhe një hamer apo letër e bardhë.

Organizimi i aktivitetit:
Fillimisht fëmijës në pamundësi të një vizite në sera mund t'i tregohet një fotografi, apo mund të vizatohet një serë. Kur kushtet e lejojnë, mund t'i tregohet një video. Pasi fëmija është prezantuar me serën, pyetet cfarë gjërash rriten në serë. A është ftohtë apo nxehtë në serë? Merren dy termometrat dhe fëmija pyetet se ku gjendet vija treguese. Me ndihmën e prindit vizatohen dy termomentrat në hamer apo letrën e bardhë. Fëmija vendos në termometrin e vizatuar vijën që tregon temperaturën. Pastaj fëmija ftohet që të fus njërin termomentër në qesen e plastikës dhe ta vendos në vend ku bie dielli dhe tjetrin e lë në temperaturën e dhomës. Çdo 10 minuta fëmija vendos në hamer se ku është vija e të dy termometrave. Gjatë kohës që vëzhgohet rritja e temperaturës në termomentrin në qese, prindi diskuton me fëmijën se cfarë ndodh në serë. Prindi diskuton me fëmijën se pse ndryshon temperatura dhe mund t'i jap shpjegime apo marrë mendime nga fëmija. Si mendon se ka hyrë nxehtësia në termometër. Diskutohet më fëmijën se pse është e rëndësishme nxehtësia për bimët dhe për çfarë përdoren produktet që merren nga sera. Ky aktivitet mund të zhvillohet me praninë e bashkmoshatërve të fëmijës (shoku apo shoqja e ngushtë).

Loja bashkëpunuese fillon nga mosha 4 - 5 vjeçare. Loja është e organizuar nga rregullat e grupit, për këtë arsye prindi duhet të lejojë që fëmija të udhëheq aktivitetin. Është e rëndësishme që prindërit të kuptojnë që gjatë kësaj moshe fëmijët lëvizin nga vetja tek loja e mbështetur në rregulla. Ky moment i zhvillimit të fëmijës i mëson ata që jeta ndërtohet nga rregulla të cilat duhen ndjekur.

Mosha 5-6 vjeç

Prindi inkurajon fëmijën të bëj lidhjen e dobisë së kafshëve dhe natyrës me njeriun.
Fëmija inkurarajohet që të demostroj aftësinë për të hulumtuar dhe zbuluar ambientin përreth.
Fëmija sqaron marrëdhëniet e thjeshta që ekzistojnë në mes bimëve, kafshëve dhe ambientit.

Aktiviteti: Çokollata në kushte shtëpie.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija ndihmon dhe merr pjesë në pregatitjen e një produkti të zgjedhur nga prindi (në këtë rast çokollata).

Materialet dhe mjete: Tavolinë, peshore, shishe me qumësht, gjalpë,

Ky aktivitet i jep mundësi fëmijës që të ketë eksperienca të reja në të cilat ai arrin të krijojë produkte, dhe të ketë mirënjohje nga prindi.

sheqer, kakao dhe mjete të kuzhinës.

Organizimi i aktiviteti:
Prindi fillimisht tregon se si do të përgatitet çokollata, dhe jep shpjegime se cilat janë produktet që ata do të duhet të mbledhin. Prindi pyet fëmijën se nga vijnë produktet të cilat nevojiten. Përpara se të fillojnë përgatitjet, prindi dhe fëmija

mund të ndërtojnë një lojë ku prindi luan rolin e fermerit, nga i cili blehet qumështi, ndërkohë fëmija mund të luaj rolin e shitësit ku blihen produktet e tjera. Gjatë përgatitjes së çokollatës fëmijët pyeten për ngjyrën e çokollatës, shijen, llojin e tyre të preferuar.

Aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijën në zhvillimin e aftësive për gjuhë dhe komunikim

- Flisni me fëmijën qetë dhe butësisht
- Përdorni fjalor të thjeshtë, dhe të saktë
- Përdorni pasqyrën dhe në pozitën përballë shqiptoni tingujt, bashkëtingujt ose shqiptimin e plotë të fjalëve që i flasin përgjysme apo me vështirësi
- Krijoni besim fëmijës gjatë bashkëbisedimit apo komunikimit, jepni mundësi të marrë pjesë në bisedë.
- Vlerësojeni fëmijën për gjërat e mira që bën duke e lavdëruar dhe duke mos i dhënë rëndësi vështësrive të tij në të folur.
- Luani lojë në imitimin e tingujve të kafshëve apo shpezëve (qeni, macja, kali, zogu, etj.) apo edhe objekteve tjera (vetura, treni, traktori, etj)
- Luani me mimika dhe shprehje të ndryshme në fytyrë (fryerja e faqeve dhe shfryerja e tyre përmes duarve)
- Përdorni shkopat e lëngjeve për të krijuar fluska në gotë
- Lejoni fëmijës që të fryjë balonat dhe pastaj të luaj me to në ajër duke i mbajtur lartë përmes frymës
- Inkurajoni fëmijën të emërtojë objektet, lodrat me emrat e të afërmve, apo edhe duke përsëritur pas jush
- Këndoni, recitoni së bashku me fëmijën, ndërkohë lejoni fëmijën të vazhdojë këngën vet
- Lejoni fëmijës të kërkojë, flas për gjërat që dëshiron, pa ndërhyrjen e juaj
- Nxiteni të flas për ngjarjet, momentet që i kaloni, duke përdoruar pyetje nxitëse (pastaj çka ndodhi, si u ndjeve, etj.)
- Lexoni libra, përralla, tregime së bashku me fëmijën, dhe diskutoni për to (figurat, karakteristikat, ngjyrat, format, etj)
- Luani me instrumente muzikore apo krijoni tinguj me objekte të ndryshme, dëgjoni muzikë.
- Diskutoni për qëllimin e objekteve (çka na shërben pjata, gota, gërshërët, librat, etj.)
- Përdorni fotografi familjare për të biseduar dhe përshkruar fotografitë dhe ngjarjet
- Flisni me fëmijën gjatë ditës, p.sh. kur jeni në makinë, gjatë larjes së fëmijës, gjatë ngrënies në tryezë, etj.

Mosha 6-18 muaj

- Prindi ndihmon fëmijën të shpreh emocionet
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të ndërtojë kuptimet e para mbi veten si person në raport me të tjerët.
- Fëmija arrinë të identifikojë pjesë të trupit kur i kërkohet nga të rriturit.

Aktiviteti: Fytyra ime

Pritshmëria nga ky aktivitet Fëmija tregon interes për pjesët e trupit të demostruara nga prindi.

Materialet dhe mjetet:

Për këtë aktivitet mund të përdoren kukulla anatomike, fotografi, kafshë lodra si dhe materiale ndihmëse, fjongo, shirit letre, pe etj.

Organizimi i aktivitetit:

Organizimi i një aktiviteti të tillë në shtëpi nuk kërkon ndonjë ngarkësë të madhe, pasi mosha e vogël e fëmijës ju lejon që edhe me objekte përreth të angazhoni fëmijën. Lidhja e një lidhëse, letër tualeti, apo fjongoje rreth qafës së një kafshe prej plastike, apo çfarëdo materiali që këni në dispozicion dhe përkundja butësisht e saj në fytyrën e fëmijës suaj. Pastaj mund ta lidhni me një shall apo pe dhe vendosni në pozicion që fëmija të mund të vëzhgojë objektin. Më pas prindi demostron me zë pjesët e trupit të objektit të përzgjedhur. Nga objekti prindi zhvendoset në trupin e tij, duke treguar po më zë pjesët e trupit dhe njëkohësisht duke vendosur gishtin tregues në pjesën që është duke treguar. Në varësi të moshës së fëmijës mund të ndiqni disa hapa:

- Kur fëmija është deri në 11-12 muaj ju mund të merrni gishtin e fëmijës dhe ndërsa emërtoni pjesën e trupit vendosni dhe dorën apo gishtin e fëmijës në trupin e tij/saj.

Nëse është mbi 12 muaj kërkoni që fëmija të tregojë me gisht pjesën e trupit p.sh: " Ku është hunda" "Ku është syri", etj. Kur fëmija është nën 12 muaj prindi nuk duhet t'i lërë fëmijës shiritat apo letrën e tualetit të luaj pa praninë e tij/saj. Ky aktivitet mund të shoqërohet me muzikë apo këngë e cila tregon pjesët e fytyrës. Nëse prindi vlerëson që fëmija nuk është i sigurtë të tregoj pjesët e fytyrës, përdor kukullën për demostrim. Gjatë aktivitetit prindi duhet të shqiptojë qartë pjesët e trupit dhe jo të përdorë gjuhë të fëmijëve. Në muajt e parë të foshnjërisë, nga lindja deri në rreth tre muaj, fëmija juaj është në lëvizje të vazhdueshme. Këto lëvizje janë të paqëllimta por e lejojnë fëmijën të krijojë bazat e para të lojës. Ndërkohë deri në muajin e gjatë lëvizjet bëhen më të kordinuara duke i dhënë mundësi fëmijës të kuptojë marrëdhënien e parë të tij me objektet përreth por dhe me trupin e vet.

Kur kushtet nuk lejojnë blerjen e kukullave apo lodrave, prindi mund të qepë vet një kukull nga pëlhura dhe vizatojnë me laps apo marker pjesët e trupit. Gjithashtu mund të përdorë vëllaun apo motrën për demostrim të pjesëve të trupit.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi ndihmon fëmijën të ndërtojë bazat e para të rutinës ditore duke bashkpunuar me të tjerët
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të nxjerrë jashtë mendime apo ndjenja të cilat mund të mos dijë t'i vendosi në fjalë dhe zhvillon aftësinë e tij për të pretenduar (lojrat e para simbolike).
- Fëmija arrinë të përdorë objekte për të pretenduar se po bëjnë punët e të rriturve.

Aktiviteti: Punët e shtëpisë

Pritshmëria nga ky aktivitet: Duke inkurajuar fëmijën që të përdorë objekte të ndyshme nga mjedisi i shtëpisë fëmija arrinë të imitojë punët e të rriturve duke ndërtuar bazat e para të të menduarit simbolik.

Materialet dhe mjetet:
Çdo gjë nga mjedisi familjar që prindi mendon se nuk është e rrezikshme për fëmijën. Luga, tenxhere, pjata plastike, lodra të cilat përfaqësojnë setet e kuzhinës apo mjete të tjera të punës në shtëpi.

Fëmijët e kësaj moshe mund të kenë vështirësi të luajnë për një kohë të gjatë, prandaj prindit i duhet t'i ofrojë fëmijës ide të reja. Fëmijëve të kësaj moshe iu pëlqejnë shumë ajo që bëjnë të rriturit. Të rriturit mund të jenë një model për fëmijët se si ata të luajnë në mënyrë të pavarur.

Organizimi i aktivitetit:
Prindi duhet t'i bashkangjitet aktivitetit të fëmijës kur është duke imituar ushqyerjen e ndonjë kukulle apo lodre. Prindi bën të njëjtin veprim duke i krijuar shoqëri fëmijës dhe mund të provojë nga pjata që ka përgaditur fëmija duke bërë komente mbi shijen. Inkurajoni fëmijën që t'ju jap me lugën e tij. Që loja të ketë vazhdimësi mund t'i tregoni si të ushqejë ndonjëren prej lodrave, mund të bëni sikur pini nga një gotë dhe e ftoni fëmijën të lani së bashku gotën. Ndërkohë që fëmija është duke ushqyer lodrën, prindi shoqëron me fjalë veprimet e fëmijës ("Je duke e ushqyer arushin, si duket është shumë i uritur").

Mosha 2-3 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën të ndërtojë konceptet e para mbështetur mbi prespektivën e tjetrit
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të ndërtojë kuptimet e para që kur dikush është lënduar apo sëmurë ka nevojë për ndihmë.
- Fëmija arrinë të identifikojë se të tjerët kanë ndjenja

Aktiviteti: Kujdesi për kafshët

Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmja tregon interes për përkujdesje ndaj të tjerëve.

Materialet dhe mjetet: Për këtë aktivitet mund të përdoren kafshë lodra prej plastike si dhe materiale ndihmëse, palloma letre, jastek, mbulesë, shtrat, fasho, pambuk,ujë etj. Në rastet kur është e mundur mund t'i ofrohet seti i lodrave të doktorit. Ky aktivitet mund të bëhet edhe me anëtarë të familjes, ku njëri pretendon se ka nevojë për ndihmë.

Organizimi i aktivitetit:
Prindi ndihmon fëmijën që të vendos lodrën e preferuar në një kuti që luan rolin e shtratit dhe i kërkon fëmijës që ta vendosi lodrën sa më rehat që mundet. Fëmija lihet në mënyrën e tij të mbulojë dhe rregullojë shtrojat për kafshën. Ndërkohë prindi pyet fëmijën se çfarë ka kafsha. Ndërkohë e ndihmon fëmijën përmes bisedës që ai/ajo të kuptojë mënyra të ndryshme të lëndimit (psh.: ka vrarë këmbën, ka lënduar veshin, po i dhemb barku etj). Prindi e ndihmon fëmijën që të kujdeset, psh.: së bashku i pastrojnë këmbën e fashojnë, japin çaj, etj).
Nëse kafsha është e sëmurë i bëhet kontrolli i mjekut. Rolin e të sëmurit mund ta luaj edhe anëtarët e familjes.

Shënim: Kur prindi luan rolin e personit të sëmurë apo lënduar nuk duhet të ekzagjerojë situatën sepse mosha e fëmijës nuk e lejon të kuptojë situatën realisht.

Mosha 3-4 vjec

- Prindi ndihmon fëmijën të njohë dhe shpreh emocionet
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të identifikojë emocionet negative dhe pozitive përmes ndërveprimit me prindërit apo personat e tjerë përreth.
- Fëmija arrinë të shpreh emocionet duke bashkpunuar me prindin apo anëtarët e tjerë të familjes gjatë lojës përmes gjuhës së folur dhe me gjeste.

Aktiviteti: Kush e gjen?
Pritshmëria nga ky aktivitet: Duke inkurajuar fëmijën që të shpreh emocionet dhe përdorin fjalët e tyre për t'i përshkruar ato, prindërit do ta kenë më të lehtë të zgjidhin konfliktet apo sjelljet e tyre në mënyrë adekuate.
Materialet dhe mjetet: Ky aktivitet nuk ka nevojë për materiale specifike.

Organizimi i aktivitetit:
Flisni me fëmijën tuaj kur ka ndjerë të ftohtë, nxehtë, inat, frikë apo lumturi. Kërkoni nga fëmija që duke përdorur duart të tregojë pa përdorur fjalët ,shprehjet: "Përshëndetje; hajde këtu; largohu; kam nxehtë; jam i frikësuar; ndalu; kam ftohtë; mirëupafshim; kam uri". Inkurajoni fëmijën që më pas të përshkruaj me fjalë veprimet, p.sh. "Jam duke luajtur duart për të treguar " mirëupafshim". Jam duke mbështjellur duart e mia se kam ftohtë" ky aktivitet mund të zhvillohet me të gjithë anëtarët e familjes duke marrë rendin secili anëtarë. Gjatë përshkrimit të emocionit, fëmija apo anëtarët mund të përmendin dhe një situatë që lidhet me emocionin, p.sh.:" Unë po friksohem; frigohem kur shoh qenin"
Ky aktivitet mund të shfrytëzohet për të inkurajuar fëmijën që të shpreh ndjenjat negative si, p.sh.: frikën dhe inatin.

Fëmijët e moshës 3-4 vjeç mund ta kenë të vështirë të shprehin emocinet, prandaj prindërit këshillohen që t'iu japin kohën e duhur si dhe mënyrën e duhur për t'i shprehur ato. Nëse fëmija ka probleme për të shprehur emocionet (sidomos ato negative) mund t'i ofrohet një lodër dhe përshkruaj si ndihet lodra. Fëmijët e kësaj moshe flasin më lehtë për të tjerët, p.sh.: lodra, vëllau apo motra e vogël, shoku apo shoqja. Është e rëndësishme që prindërit të mbështesin fëmijën në aktivitetet e tyre duke i ndihmuar ata të mësojnë për të shprehur ndjenjat. Këtu prindërit mund të përdorin materiale të ndryshme. Materialet mund të përfshijnë ngjyra, penë shkrimi, lapsa me ngjyra, me qëllim të aftësimit të fëmijës për të vizatuar, apo kopjuar. Ndërkohë ofrimi i materialeve si balta, uji, dhe sfungjeri për të përjetuar material të ndryshme. Të gjitha këto materiale e lejojnë fëmijën të jetë kreativ, dhe lehtësojnë procesin e përpunimit dhe shprehjes së emocioneve.

Mosha 4-5 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën të shpreh emocionet për të tjerët
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të njoh dhe ndaj emocionet e tij për bashkëmoshatarët me familjarët.
- Fëmija arrinë të ndajë emocionet e tij me të tjerët.

Aktiviteti: Kush e gjen?
Pritshmëria nga ky aktivitet: Duke inkurajuar fëmijën që të shpreh emocionet dhe përdorin fjalët e tyre për t'i përshkruar ato, prindërit do ta kenë më të lehtë të zgjidhin konfliktet apo sjelljet e tyre në mënyrë adekuate.
Materialet dhe mjetet: Letër e verdhë apo me ngjyrën e preferuar të fëmijës, ngjitës, gërshërë, laps, një maice e thjeshtë e vjetër si dhe një gotë apo kuti.
Nëna mund të pregatisë brum për biskota dhe biskotave t'ju jap formën e shkronjës së parë me të cilin i fillon emri i shoqes apo shokut.

Organizimi i aktivitetit:
Forma e parë e aktivitetit: Uleni së bashku me fëmijën në dysheme. Vizatoni ylla në fletën me ngjyra dhe me ndihmën e fëmijës bëni disa ylla të mëdhenj. Prindi shkruan në secilin yll emrin e një shoku apo shoqe të fëmijës. Ylljet fëmija i vendos në një kuti apo enë të cilën mund ta përziejë. Inkurajohet fëmija të nxjerrë nga një yll dhe t'i ofroj prindit për të lexuar emrin.
Forma e dytë e aktivitetit. Pasi të piqen në furrë biskotat dhe pasi të jenë ftohur, fëmija përzgjedh biskotat sipas shkronjave. Pas përzgjedhjes prindi lexon emrin apo tregon shkronjën dhe inkurajon fëmijën të tregojë çfarë i pëlqen tek shoku që ka emrin në yll, apo biskotën me shkronjën e parë të emrit. Prindi pyet fëmijën të thotë disa gjëra që i ka shoku/shoqja i/e identifikuar. P.sh. Si i ka sytë?, A t'i jep lodrat?; A flini bashkë? Çfarë bëni bashkë, etj.
Çdo yll që zgjidhet ngjitet në maice dhe lejohet fëmija ta mbaj veshur gjithë ditën.
Biskotat fëmija nëse dëshiron ua shërben edhe njerëzve të tjerë në shtëpi.

Fëmijët e vegjël janë shumë krenar kur arrijnë të bëjnë gjëra të ndryshme si me prindërit si edhe me persona të tjerë. Familja është mjedisi ku fëmijët inkurajohen për ndjenjën e krenarisë dhe konfidencës. Ndërkohë ky është një aktivitet në të cilën prindi informohet për socializimin e fëmijës në kopësht. Aftësia për të bërë shokë apo shoqe është e një rëndësie të veçantë për zhvillimin e fëmijës në këtë moshë, pasi ndikon në krijimin e imazhit të tij/saj.

Mosha 5-6 vjeç

- Prindi ndihmon fëmijën të zhvillojë konceptin e punës së përbashkët
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të kuuptojë që për të arritur një qëllim të caktuar i nëvojitet që të bashkpunojë.
- Fëmija përmes bashkpunimit me familjarët arrinë të përfundojë aktivitetin.

Aktiviteti: Treni
Pritshmëria nga ky aktivitet: Duke inkurajuar fëmijën që të ndaj me personat e tjerë arrin në një rezultat (konkretisht ndërtimin e trenit)
Materialet dhe mjetet:
Kutia kartoni (nëse nuk ka të gatshme mund të punohen me fëmijën me karton dhe ngjitës), markerë, ngjyra, letër me ngjyra, ngjitës, gërshërë.

Organizimi i aktivitetit:
Ky aktivitet do të ishte më fuksional nëse thërriten edhe bashkëmoshatrë të fëmijës në shtëpi.
Merren disa kuti kartoni të cilat do të shërbejnë si vagona. Fillimisht fëmijët apo anëtarët e familjes shpenzojnë kohë së bashku duke ngjyrosur vagonat (kjo është arsyeja pse vagonët duhet të jenë të kartonit). Secili vendos një shenjë që i pëlqen në vagonin e tij/saj. Është mirë që gjatë kësaj loje të vendosen vetëm një palë lapsa me ngjyra në mënyrë që pjestarëve të lojës t'i duhet të ndajnë më njëri tjetrin dhe të mundohen të bëjnë kompromise. Pastaj vagonët lidhen me njëri tjetrin. Ndërkohë pyeten të gjithë pjestarët se cfarë bënin kur nuk kishin lapsin që ju nevojitej (p.sh., ngjyrosa anën që e kisha lapsin ndërsa prisja). Nëse fëmija apo ndonjë pjestar ka vështirësi në këto pyetje, prindi mund të jap modelin e të punuarit altrnativ (p.sh., ndërsa unë po prisja lapsin e kuq u mora me rrotat e vagonit tim, apo përdora markerin për të vizatuar një figur).

Në fund vagonat e ngjitur mund të mbushen me kafshë të preferuara, fruta apo objekte të tjera dhe fëmijët e sjellin nëpër dhomë dhe ndërtojnë storie se ku janë duke shkuar dhe çfarë duan të bëjnë me trenin e ndërtuar.

Loja bashkëpunuese fillon nga mosha 5 vjeçare. Loja është e organizuar nga rregullat e grupit.
Ka të paktën një fëmijë që udhëheq dhe fëmijët në këtë moshë ose janë në lojë, ose jashtë saj. Është e rëndësishme që prindërit të kuptojnë që gjatë kësaj moshe fëmijët lëvizin nga vetja tek loja e mbështetur në rregulla. Ky moment i zhvillimit të fëmijës i mëson ata që jeta ndërtohet nga rregulla të cilat duhen ndjekur.

Aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijën në zhvillimin e aftësive në fushën sociale dhe emocionale

- Përkrahni fëmijën për të identifikuar emocionet e veta (p.sh. "Unë jam i gëzuar sepse...." ose "unë po qaj sepse...."
- Bashkëbisedoni dhe nxiteni fëmijën të shpreh ndjenjat e tij/saj (p.sh. pas një feste, pas një grindje, etj.)
- Diskutoni se si duhet të sillemi në situata të ndryshme
- Përdorni përrallat, tregimet për të ndihmuar fëmijët të marrin në konsideratë ndjenjat e të tjerëve
- Inkurajoni fëmijën të jap ndihmë apo të ndajë lodrat me fëmijët tjerë
- Mundohuni të mos i qëndroni fëmijës tuaj prapa duke e kontrolluar, lejoni fëmijën të ketë argëtim. Ju mund ta ndihmoni apo ndërhyni vetëm nëse fëmija juaj ka nevojë për të
- Lavdërojeni fëmijën si për përpjekjet ashtu edhe për arritjet (e di që kjo është e vështirë për ty, por e ke nisur mirë)
- Bëjini lavdërimet specifike dhe të çiltra (tregojini fëmijës qartësisht përse jeni i kënaqur me të (më pëlqeu shumë se si u përpoqe t'i veshësh vetë këpucët)
- Mësojeni të flas pozitivisht për veten. Duke e inkurajuar fëmijën të verbalizojë gjërat e mira që bën, ju do t'a ndihmoni në zhvillimin e një imazhi pozitiv për veten dhe në rritjen e vetëvlerësimit, p.sh. "unë jam bërë shumë i zoti për të mbërthyer vetë zingjirin"
- Përdorni shpërblimet për sjelljet dhe veprimet e mira, këto mund të jenë (përqafimet, buzëqeshjet e fytyrat e qeshura, fjalët e mira dhe inkurajuese deri te koha e veçantë e kaluar me fëmijën)
- Tregoni mos aprovim për sjellje jo të duhur, (psh. kur e qëllon Gentin me shkelm atij i dhemb dhe mërzitet shumë, gjithashtu më mërzit edhe mua. Unë e di që Gentit i pëlqen të luaj me ty dhe ju luani zakonisht shumë mirë së bashku).

Mosha 6-18 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën të luajë me figura gjeometrike.
- Aktiviteti ndihmon fëmijën që të dallojë figurat themelore gjeometrike.
- Fëmija arrin që nëpërmes lojës të dallojë formën e katrorit dhe të trekëndëshit dhe të manipulojë me to.

Aktiviteti: Treni
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija dallon formën e katrorit dhe trekëndëshit gjatë lojës.

Materialet dhe mjetet: Lodra plastike në formë katrori dhe trekëndëshi.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që fëmija të dallojë format gjeometrike, me fokus katrorin dhe trekëndëshin. Lodrat plastike me forma gjeometrike janë një mjet shumë i mirë për të arritur këtë qëllim. Luani me lodra plastike të formave të ndryshme gjeometrike sa më shpesh. Bisedoni sa më shumë me fëmijën gjatë lojës. Nxitni fëmijën që të krijojë figura të ndryshme me to. Lavdëroni atë për punën që bën gjatë lojës.

Organizimi i aktivitetit:
Vendosni në dysheme mjaftueshëm lodra plastike në formë katrori dhe trekëndëshi. Inkurajo fëmijën që të luajë me to duke qenë edhe vetë pjesëmarrës në lojë. Duke luajtur së bashku formoni trenin dhe figura të tjera. Gjatë tërë kohës bisedoni me fëmijën, duke i kërkuar një katror, një trekëndësh e kështu me radhë. Poashtu gjatë tërë kohës sa luani së bashku stimulo, udhëzo, përforco dhe lavdëro punën e fëmijës. Lojëra të këtilla mund të luani edhe në ambient të jashtëm. Mund të përdorni lodra plastike edhe të formave të tjera gjeometrike. Lodrat plastike mund të jenë me ngjyra të ndryshme, ku fokusi mund të jetë dallimi i ngjyrave. Lodrat plastike mund të jenë të madhësive të ndryshme, ku fokusi mund të jetë madhësia.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën që të formojë sajuese me figura të ndryshme gjeometrike.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën që të zhvillojë të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive.
- Stimuloni, nxitni, kërkoni nga fëmija që të luajë me figura gjeometrike.

Aktiviteti: Formojmë sajuese
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija formon sajuese (puzzle) duke vendosur figurat gjeometrike në vendin e duhur.

Materialet dhe mjetet: Sajuese (puzzle) me forma të ndryshme gjeometrike.

Organizimi i aktivitetit:
Sajueset (puzzle) mund të jenë të gatshme, por ato mund t'i krijoni edhe ju si prindër duke vizatuar dhe ngjyrosur në letër më të trashë ndonjë figurë dhe duke e prerë në pjesë që janë me forma të ndryshme gjeometrike.

Luani me fëmijën tuaj duke i përzier pjesët e sajueses dhe inkurajoni që të formojnë sajuesen duke i vendosur format gjeometrike në vendin përkatës.
Lavdëroni fëmijën gjatë tërë kohës dhe ndihmoni atëherë kur ka nevojë.
Në fillim sajueset mund të jenë më të thjeshta (domethënë me më pak pjesë), por me kalimin e kohës, nëse e shihni që fëmija po kënaqet me këtë aktivitet dhe me lehtësi po formon sajuesen, atëherë mund të krijoni sajuese të cilat kanë më shumë pjesë dhe që janë më sfiduese.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që fëmijët të zhvillojnë edhe më tutje të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe madhësive. Është karakteristikë e fëmijëve të moshës 18 – 24 muajsh që të formojnë sajuese të thjeshta (p.sh. kompletojnë një sajuese me tri apo katër pjesë).

Fëmijët e kësaj moshe poashtu mund të krijojnë struktura të thjeshta tredimensionale duke përdorur lloj të njëjtë të formës, p.sh. kubin. Sa më i pasur të jetë mjedisi i lojës së fëmijës, aq më shumë do të përfitojë fëmija në të gjitha fushat e zhvillimit.

Mosha 2-3 vjeç

Prindi stimulon, inkurajon, mbështet zhvillimin e të kuptuarit të figurave gjeometrike.
Aktiviteti e ndihmon fëmijën të dallojë figurat gjeometrike dhe karakteristikat e tyre.
Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të ndjekë udhëzimet të cilat ju ia jepni. Prindi stimulon, inkurajon, mbështet zhvillimin e të kuptuarit të figurave gjeometrike.

Aktiviteti: Gjeje të njëjtën
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija ndjek udhëzimet e dhëna.
Materialet dhe mjetet: Forma të ndryshme gjeometrike (me ngjyra të ndryshme dhe madhësi të ndryshme) të prera nga një letër më e fortë (mund të jetë nga kutitë e zbrazëta të këpucëve).

Organizimi i aktivitetit:
Format e ndryshme gjeometrike (të cilat i keni krijuar më herët) vendosni në dysheme dhe filloni lojën "Gjeje të njëjtën". Merre një formë gjeometrike nga grumbulli i formave dhe kërko nga fëmija që të gjejë një të njëjtë si ajo që ke në dorë. Është me rëndësi që nga secila formë gjeometrike (me madhësi dhe ngjyra të ndryshme) të jenë së paku nga dy të njëjta. Në fillim përdor vetëm format e katrorit, rrethit dhe trekëndëshit (të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme). Nëse është nevoja atëherë ndihmojeni fëmijën në fillim për t'i gjetur. Në vazhdim lojën mund ta bëni më sfiduese duke shtuar më shumë forma të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme. Ndihmojeni fëmijën aq sa ka nevojë, në mënyrë që të jetë i suksesshëm gjithmonë gjatë lojës. P.sh. tregoi me gisht se cila formë po kërkohet, drejtoje dorën e tij te ajo formë, apo afrojani formën e ngjashme.

Qëllimi kryesor i aktivitetit është që fëmija të zhvillojë të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive. Gjatë kësaj periudhe të zhvillimit, fëmijët krijojnë piktura duke përdorur një formë gjeometrike, por ende nuk i përdorin format të kombinuara. Sa më shumë lojë me forma gjeometrike, e bëjnë më të lehtë përdorimin e tyre nga fëmija në situata të ndryshme.

Mosha 3-4 vjeç

• Prindi inkurajon dhe stimulon fëmijën që të lidhë numrin me sendet e ndryshme.
• Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e të kuptuarit të numrave dhe numërimit.
• Udhëzoni, inkurajoni, kërkoni që fëmija të marrë aq objekte sa është numri i dhënë.

Aktiviteti: Mickey mouse thotë...
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija merr aq objekte sa është numri i dhënë.
Materialetdhe mjetet: Objekte të ndryshme që gjenden në shtëpi.

Fëmija mëson më së miri nëpërmjet lojës. Atëherë sa herë që kemi mundësi të shfrytëzojmë lojën për t'u kënaqur me fëmijën tonë dhe njëkohësisht t'i mësojmë koncepte të ndryshme në mënyrë të natyrshme dhe pa presion. Gjërat që mësohen gjatë lojës do të mbesin më gjatë në kujtesën e fëmijës.

Organizimi i aktivitetit:
I tregoni fëmijës që së bashku do të luani lojën "Mickey mouse thotë..." (Mickey mouse mund ta ndërroni me ndonjë personazh tjetër të dashur për fëmijën). Së pari fëmijës i shpjegoni rregullat e lojës.
I thoni që kur unë them "Mickey mouse thotë t'i sjellësh në mes të dhomës dy lodra, atëherë duhet të shkosh e t'i gjesh dhe t'i sjellësh këtu". Loja vazhdon me kërkesa të ndryshme dhe numra të ndryshëm, por gjithmonë duke u siguruar që atë që kërkoni fëmija mund ta gjejë.
Gjatë kësaj loje ju mund të ndërroni rolet dhe fëmija të jetë ai që paraqet kërkesat.
Po ashtu këtë lojë mund ta luani edhe me më shumë persona.
Lojën mund ta luani edhe në ambient të jashtëm.

Mosha 4-5 vjeç

• Prindi inkurajon, stimulon, mbështet fëmijën që të krijojë modele matematikore.
• Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e aftësive të përdorimit të materialeve për krijimin e modeleve matematikore.
• Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të krijojë modele matematikore me materialin e afruar.

Aktiviteti: Punojmë me makarona.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija krijon modele matematikore.
Materialetdhe mjetet: Fije peri (më e trashë), makarona, ngjyra (uji, tempera etj).

Organizimi i aktivitetit:
Së bashku me fëmijën i ngjyrosni makaronat. Disa me ngjyrë të kuqe, disa me ngjyrë të kaltër, disa me të verdhë, apo edhe me ngjyra të tjera sipas dëshirës së fëmijës. Për t'i ngjyrosur mund të përdorni ngjyra uji, tempera etj.
Merrni fije peri pak më të trashë dhe kërkoni nga fëmija që të krijojë vargje me makarona.
Një varg mund ta krijojë duke vendosur nga një makaron prej secilës ngjyrë dhe

duke e përsëritur këtë model. Vargun tjetër duke i vendosur nga dy makarona nga secila ngjyrë dhe duke e përsëritur modelin. Sfidojeni fëmijën që të mendojë vetë dhe të jetë kreativ në formimin e modeleve me makarona. Lavdërojeni për punën e bërë. Aktivitete të tilla mund të bëni edhe me materiale të tjera. Poashtu modelet mund t'i krijoni prej më të ndryshmeve.

Matematika është shkencë e modeleve dhe marrëdhënieve. Atëherë të fillojmë që në këtë moshë t'i sfidojmë fëmijët tanë në këtë fushë.
Fëmijët e moshës 4 – 5 vjeçare kanë një interes të shtuar për të mësuar konceptet matematikore. Ata zgjidhin problemet e përditshme në mënyrë logjike. Përdorin gjuhën e duhur për të përshkruar dhe krahasuar objektet dhe format. Ata mund të numërojnë deri në 10. I dallojnë numrat e shkruar prej 0 – 9, si dhe mund të mbledhin e zbresin deri në numrin 4. Poashtu i dallojnë disa lloje të rrathëve, katrorëve, trekëndëshave dhe drejtkëndëshave.

Mosha 5-6 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e shkathtësive matematikore të fëmijës.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e të kuptuarit të numrave dhe numërimit
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të numërojë aq gjëra sa tregon numri.

Aktiviteti: Luajmë me numra.
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmija numëron aq gjëra sa është numri.
Materialet dhe mjetet: Një paketim i zbrazët i vezëve, një enë, fasule (në vend të fasuleve mund të jenë arra, gështenja, makarona apo ndonjë material tjetër i përshtatshëm).

Organizimi i aktivitetit:
Merrni një kuti të zbrazët të vezëve. Në secilën zbrazëtirë shkruani një numër (prej 0 – 9). Numrat mund të përsëriten. Poashtu në një enë vendosni fasule (apo makarona, arra, gështenja etj.). Nxitni fëmijën që të vendos aq gjëra sa thotë numri. Gjatë tërë kohës lavdërojeni fëmijën për punën që bën. Nëse ka nevojë ndihmojeni gjatë aktivitetit.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është zhvillimi i të kuptuarit të numrave dhe numërimit.
Sa më shumë ushtrime të këtij lloji, fëmija do të jetë më i gatshëm për fillimin e klasës së parë.
Fëmijët e kësaj moshe janë mjaft kuriozë, energjikë dhe entuziastë. Prandaj duhet të kemi parasysh karakteristikat e zhvillimit unik të tyre, kur zgjedhim aktivitetet të cilat do t'i bëjmë me ta.

Aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijën në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të jetës së përditshme

- Krijoni rutinën ditore në shtëpi, si: koha e ushqimit, fjetjes/pushimit, lojës me lodra, aktiviteteve jashtë shtëpisë, televizionit, kompjuterit, muzikës, etj., sepse kjo do të lehtësojë pavarësimin e fëmijës dhe përshtatjen me vendet tjera jashtë shtëpisë
- Po ashtu gjatë lojës në natyrë apo parqe të ndryshme lejoni fëmijën të takoje fëmijë të tjerë duke inkurajuar ndarjen e lodrave bashkë, komunikimin me fëmijë tjerë, tregoni se si duhet me radhë të luhet një lojë, etj.
- Inkurajoni pavarësimin e fëmijës, gradualisht filloni ta leni fëmijën tuaj për një kohë të shkurtër me të afërmit tuaj, gjyshërit, apo miqtë tuaj. Praktikoni këtë mënyrë duke filluar për një kohë të shkurtër deri sa ju shkoni në dyqan apo kryeni punë tjera duke vazhduar kohëzgjatjen çdo ditë e më shumë. Tregoni fëmijës suaj se ju do të ktheheni shumë shpejt dhe do ta merrni.
- Gjatë kohës së lojës në oborr apo parqe lejoni fëmijës hapësirë të lirë për të hulumtuar natyrën apo duke luajtur me rërë, me baltë, ujë, ngjyra, etj.
- Përmes letrave, kartonëve dhe materialeve recikluese krijoni gjëra të ndryshme.
- Lejoni të vizatoj me ngjyra dhe laps
- Kufizojeni kohën e fëmijës për televizor, kompjuter dhe pajisje tjera, për fëmijë të moshës 2-6 vjeç (fëmija mund të ketë qasje jo më shumë se një orë në ditë).
- Praktikoni shprehitë e të ushqyerit, toaletit, pastrimit përmes lojës me kukulla dhe dramatizoni situata që shfaqin shprehi të tilla.

Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimi

Mosha 6-18 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën të tregojë me fjalë disa figura në librin e ilustruar.
- Aktiviteti ndihmon zhvillimin gjuhësor të fëmijës.
- Fëmija arrin të mësojë nëpërmjet lojës nëse i ofrohen mjetet e nevojshme. Përmes pyetjeve të ndryshme, nxitni fëmijët që të tregojnë me fjalë figurat që shohin në libër.

Aktiviteti: Lexojmë së bashku.
Rezultati i pritur nga aktiviteti: Fëmija tregon me fjalë disa figura që sheh në librin e ilustruar.
Materialet dhe mjetet: Libra me ilustrime të kafshëve.
Organizimi i aktivitetit:
Së bashku me fëmijën uluni në divan, apo shtrijuni në dysheme dhe filloni të shfletoni librin me ilustrime të kafshëve. Diskutoni ilustrimet përderisa jeni duke shfletuar librin së bashku. Nëpërmjet pyetjeve, nxitni fëmijën që t'ju tregojë se çfarë po sheh. Kërko që të tregojë me gisht figurat e caktuara në faqe.
Keni parasysh:
Është mirë që të krijoni një kënd të leximit me mjaft libra të përshtatshëm për moshën.
Librat duhet të jenë në një vend të përshtatshëm që fëmija mund t'i arrijë vetë.
Librat me ilustrime nxisin kurreshtjen e fëmijës.
Zhvillimi i aktiviteteve të këtilla në këtë moshë, siguron një zhvillim të gjithanshëm të fëmijës.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që fëmija të zhvillojë të folurit. Andaj libri është një mjet shumë i mirë për të arritur këtë. Lexojini fëmijës tuaj çdo ditë dhe atë disa herë në ditë. Bëni sa më shumë pyetje gjatë leximit. Mundohuni që librat të cilët ia ofroni fëmijës të jenë sa më interesantë dhe të nxisin kërshërinë e tyre. Përveç zhvillimit gjuhësor ne zhvillojmë edhe dashurinë për librin.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën që të komunikojë lirshëm.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën që nëpërmjet lojës të zhvillojë shkathtësitë e komunikimit.
- Stimuloni, nxitni, kërkoni nga fëmija që të komunikojë pa hezitim.

Qëllimi kryesor i aktivitetit është që fëmija të përforcojë shkathtësitë e komunikimit. Biseda me kukullat e dorës i inkurajon fëmijët për bashkëveprim, si dhe për zhvillimin e gjuhës. Kukullat e thjeshta të dorës janë më të mirat për këtë moshë.

Aktiviteti: Kukullat që flasin
Rezultati i pritur: Fëmija bisedon me kukullën.
Materialet dhe mjetet: Kukulla dore në formë të kafshëve (p.sh. mace, qen, rosë etj.) të cilat mund t'i krijoni vetë.
Organizimi i aktivitetit:
Vendoseni kukullën në dorë. Bisedoni me fëmijën dhe inkurajojeni atë të flasë me kukullën. P.sh. "Unë jam qeni. Unë them: Ham, ham". Kërkoni nga fëmija që të imitojë zërin, fjalët, apo veprimet që ju i bëni me kukullën e dorës. Në vazhdim lejoni fëmijën që të eksperimentojë, duke e vendosur kukullën në dorën e tij/saj. Përdorni kukullën e dorës për të pasur një "bisedë" me fëmijën. Jepni fëmijës kohë të përgjigjet në pyetjet që i bëni, si dhe të mendojë bisedën që ai do të bëjë. Këtë aktivitet mund ta përsërisni kohë pas kohe, duke përdorur kukulla dore me personazhe të ndryshme.

Mosha 2-3 vjeç

- Prindi stimulon, inkurajon, mbështet zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit aktiv të fëmijës.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën të zhvillojë shkathtësitë e të dëgjuarit aktiv dhe të përcjellë udhëzimet.
- Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të ndjekë udhëzimet të cilat ju ia jepni.

Aktiviteti: Rruga me pengesa
Rezultati i pritur: Fëmija ndjek udhëzimet e dhëna.
Materialet dhe mjetet: Materiale të ndryshme të cilat i keni në shtëpi, p.sh. një letër apo gazetë, një kuti, jastëk, plaf etj.
Organizimi i aktivitetit:
Përdorni objektet që i keni në shtëpi për të krijuar një rrugë me pengesa. Shpjegoni fëmijës që ai/ajo duhet të dëgjojë udhëzimet dhe t'i ndjekë ato me korrektësi. Së pari vendosni objektet në dysheme, në mënyrë që fëmija të mund t'i realizojë udhëzimet tuaja.
Filloni me udhëzimet: "Shkel mbi letër. Kalo mbi jastëk. Zvarritu nën plaf. Ulu brenda në kuti.". Fillimisht udhëzimet jepni një nga një, derisa fëmija të kuptojë se çka i kërkohet. Këtë aktivitet kthejeni në lojë, duke i dhënë dy udhëzime në të njëjtën kohë dhe duke e sfiduar fëmijën që t'i kryejë ato sa më shpejt që mundet. Për të kompletuar udhëtimin, fëmija duhet të jetë dëgjues i vëmendshëm për secilin udhëzim. Ju mund të vazhdoni lojën duke i ndërruar

rolet dhe duke parë se a po mundet fëmija të drejtojë lojën duke dhënë udhëzimet. Para çdo udhëzimi pyeteni fëmijën: "Çka duhet të bëj tani?". Këtë aktivitet mund ta zhvilloni edhe në ambient të jashtëm duke përdorur material të ndryshëm për të krijuar pengesat.

Qëllimi kryesor i aktivitetit është që fëmija të zhvillojë të dëgjuarit aktiv. Ju mund të krijoni edhe aktivitete të tjera në të cilat fëmijët i vendosni para "detyrave" apo "sfidave". Fëmijët i pëlqejnë shumë sfidat dhe ata do të angazhohen me shumë dëshirë në këto detyra. Ju vetëm siguroni një ambient të sigurtë për fëmijën dhe kushtoni kujdes vlerësimit të fëmijës për mundin që ka bërë, si dhe për rezultatin që ka arritur. Pra, mos harroni që fëmijën ta përgëzoni kur realizon një detyrë apo përmbush me sukses një sfidë. Në këtë moshë fëmijët kanë dëshirë të provojnë gjëra të reja dhe të eksplorojnë botën rreth tyre në mënyrë aktive. Ata shumë shpesh zgjedhin aktivitetet e tyre dhe nuk kanë dëshirë që gjithmonë t'iu thuhet se çka të bëjnë.

Mosha 3-4 vjeç

- Prindi inkurajon, stimulon, mbështet fëmijën për zhvillimin e aftësive të të shkruarit.
- Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e aftësisë për të shkruar
- Udhëzoni, inkurajoni, kërkoni që fëmija të vizatojë simbole dhe shenja të ndryshme.

Aktiviteti: Lulet
Rezultati i pritur: Fëmija vizaton lulen sipas shembullit të dhënë.
Materialet dhe mjetet: Fletë e bardhë, ilustrime të luleve, laps, ngjyra (të drurit apo të ujit).
Organizimi i aktivitetit:
Së bashku me fëmijën merrni të gjitha materialet që iu duhen: fletën e bardhë, ilustrimet e luleve, laspin, ngjyrat (të drurit apo të ujit). Këto materiale vendosni në vendin ku ju do të punoni së bashku me fëmijën.
Fillimisht bisedoni me fëmijën për stinën e pranverës. Parashtroni pyetje si: "Si është natyra në pranverë? Cila lule të pëlqen më shumë? Si duhet të kujdesemi për lulet? etj."
Pas bisedës e nxisni fëmijën që të vizatojë dhe të ngjyrosë një lule të ngjashme me ndonjërën nga lulet që sheh në ilustrim. Stimuloni fëmijën që të përdorë cilëndo ngjyrë që dëshiron në ngjyrosjen e lules. Përderisa fëmija është duke punuar, lavdërojeni për punën e tij/saj. Në fund punimin e fëmijës e vendosni në një vend të dukshëm.

Këtë aktivitet mund ta zhvilloni edhe në oborr apo ballkon, si dhe mund të përdorni edhe materiale të tjera sipas dëshirës. Po ashtu nëse keni lule përreth, mund të kërkoni që fëmija të vizatojë lule pa i ofruar për t'i parë ilustrimet e tyre.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmija të kuptojë bazën e të shkruarit në mënyrë të natyrshme, por edhe të krijojë shprehitë e para të të shkruarit. Është shumë e rëndësishmë që gjatë aktiviteteve të këtilla fëmija të ndjejë kënaqësi dhe të mos shqetësohet se a është duke i bërë format në mënyrë perfekte. Për këtë arsye prindi vazhdimisht duhet ta inkurajojë dhe ta lavdërojë gjatë punës.

Mosha 4-5 vjeç

• Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e aftësive të të shkruarit te fëmija.
• Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e aftësive të përdorimit të duarve dhe gishtave
• Udhëzoni, stimuloni, kërkoni që fëmija të shkruajë shkronjat në materialin e ofruar.

Aktiviteti: Shkronjat e alfabetit
Rezultati i pritur: Fëmija paraqet grafikun e shkronjave.
Materialetdhe mjetet: Letra me shkronja të ndryshme, një tepsi, kripë.
Organizimi i aktivitetit:
Në letër shkruani shkronja të ndryshme. Është mirë që në një letër të jetë një shkronjë. Këto letra vendosni mbi tavolinë. Mbushni një tepsi me një shtresë të hollë kripe. Edhe këtë vendosni mbi tavolinë. Kërkoni nga fëmija që shkronjat të cilat janë në letër t'i shkruajë në kripë. Gjatë këtij aktiviteti lavdëroni fëmijën për punën që bën. Fëmijët e kësaj moshe kënaqen duke luajtur me materiale të tilla.

Aktivitetet e tilla stimulojnë zhvillimin e muskujve të vegjël tek fëmija, gjë që në të ardhmen do të lehtësojë procesin e të shkruarit të tij/saj. Njëkohësisht, nëpërmjet aktiviteteve të këtilla në formë të lojës, fëmija do të njihet me grafikun e shkronjave.

Mosha 5-6 vjeç

• Prindi inkurajon, stimulon, mbështet zhvillimin e vetëdijes tingullore te fëmija.
• Aktiviteti e ndihmon fëmijën në zhvillimin e vetëdijes tingullore, më saktësisht në dallimin e tingujve në fjalë të ndryshme.
• Udhëzoni, kërkoni që fëmija të luajë me tinguj në fjalë të ndryshme.

Aktiviteti: Luajmë me tinguj.
Rezultati i pritur: Fëmija dallon tingujt në fjalë të ndryshme.
Materialet dhe mjetet: Asnjë.

Organizimi i aktivitetit:
Këtë aktivitet mund ta zhvilloni në çdo kohë dhe në çdo vend. Luani me fëmijën tuaj duke dalluar, ndërruar, hequr apo shtuar tingujt në fjalë të ndryshme. Filloni së pari me emrin e fëmijës. P.sh. E pyetni fëmijën se cili është tingulli i parë në emrin e tij. Nëse emri është Riga, atëherë tingulli i parë është R. Pastaj e pyet se cili është tingulli i fundit në emrin e tij/ saj. Në këtë rast është A. Lojën e vazhdoni duke kërkuar që të ndërrojë tingullin e parë me tingullin T. Atëherë emri bëhet Tiga. Mund të vazhdoni edhe me tinguj të tjerë. Poashtu mund të kërkoni që të heq tingullin e parë. Në këtë rast emri bëhet Iga. Lojën mund ta vazhdoni me ndonjë fjalë tjetër. Po ashtu mund të ndërroni rolet. Atëherë fëmija ju parashtron kërkesat.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është zhvillimi i vetëdijes tingullore te fëmijët, si një ndër komponentet kryesore të zhvillimit gjuhësor. Sa më shumë ushtrime të këtij lloji, fëmija do të jetë më i gatshëm për fillimin e klasës së parë. Fëmijët të cilët kanë vështirësi me vetëdijen tingullore, në të ardhmen do të kenë vështirësi edhe në të lexuar. Prandaj është mirë që të zhvillojmë sa më shumë lojëra të këtilla me tinguj, të cilat do t'iu ndihmojnë fëmijëve që të jenë lexues më të mirë në të ardhmen

Mosha 6-18 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
- Aktiviteti ndihmon fëmijën të zhvilloj ndjenjën ritmike
- Fëmija lëviz në koordinim me ritmin e këngës

Aktiviteti: kënga "tapshin tapshin ta- na- no"
Pritshmëria nga ky aktivitet: Fëmiu përjeton këngën dhe bënë lëvizje në harmoni me ritmin e këngës.
Materialet dhe mjetet: Intresimin e fëmijës e tërheqin duart e veta me të cilat, duke i shikuar, fillon të luaj.

Organizimi i aktivitetit:
Me duart e fëmijës aplikojmë lojën: i flasim fëmijës "m'i jep duart ", i zgjasim nga ai duart tona dhe kapim duart e tij/saj. Me këndimin e melodisë, e cila mban ritëm të shpejtë, lehtas lakojmë duart e fëmijës, para mbrapa gjersa të mos e përfundojmë melodinë. Në vazhdim marrim në duar shuplakat e fëmijës duke kënduar, i hapim duart e tij anash dhe prapa, duke i tërhequr në krahëror të fëmijës. Lojën e përsërisim disa herë duke e kënduar më shpejtë tekstin:
Tap-shin tap-shin ta-na-no
Tro-ket do-ra vo-gel – o
Duartrokasim me duart e fëmijës shuplakën me shuplakë .
Të njëjtën lojë e aplikojmë edhe me këmbët e fëmijës, e kapim për shputa, ngadal ia lakojmë këmbët në gjunjë, këndojmë këngën:
Tap-shin tap-shin ta-na-no
Tro-ket këm-ba vo-gel – o
e njëherësh lëvizim këmbët e fëmijës.
Lojërat me duar dhe me këmbë mund t'i luajmë në çdo kohë, por mund ta aplikojmë edhe gjatë kohës së veshmbathjes.
Në këtë lojë zakonisht fëmija përgjigjet me buzëqeshje, me gugatje dhe me gjallëri. Gjatë aktivitetit nëse prindi nuk është në gjendje të këndojë vet, atëherë mund ti shfrytëzoj paisjet teknologjike (telefoni i xhepit, cd-player, llop top etj). Nëse i përdorim paisjet teknologjike duhet pasur kujdes në forcën e tingullit që të jetë më e "lehtë". Lojërat lëvizëse dhe ritmike janë shumë atraktive për fëmijët e kësaj moshe, sepse në to nuk marrin pjesë vetëm si dëgjues por edhe si interpretues aktiv.

Mosha 18-24 muaj

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
- Aktiviteti ndihmon fëmijën të zhvillojë ndjenjën melodike
- Fëmija dallon tingujt e ndryshëm nga instrumentet apo lodrat që lëshojnë zë

Aktiviteti: Lojërat e fshehjes
Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmija dallon tingujt e ndryshëm dhe imiton ato
Materialet dhe mjetet: Instrumente të ndyshme fëmijërore ritmike dhe melodike

Organizimi i aktivitetit:
Aplikimi i kësaj loje mund të bëhet në shumë variante psh: në shtëpi, në oborr, në natyrë etj.
Fshihemi diku në ambient të përshtatshëm dhe me zë të lehtë thërrasim fëmijën në emër. Fëmija kërkon të na gjejë duke u përpjekur të përcaktoj vendin sipas zërit. Nëse fëmija nuk na gjenë, kështu edhe ndodh në fillim, derisa fëmija ta kuptojë lojën, dalim nga vendi ku jemi fshehur dhe paraqitemi me zë "ja ku jam". Lojën e pasurojmë duke u fshehur më lodër që lëshon tingull ose ndonjë instrument ritmik (trekëndësh, shkopinjë, tupane, daulle e vogël etj.) ose imitojmë kafshët me zëra të ndryshëm.
Fëmija kërkon lodrën, instrumentin apo zërin tonë sipas tingujve që lëshojnë. Në momentin që fëmija na gjenë ku jemi fshehur së bashku imitojmë tingullin e lodrës, inertumentit apo tingëllimën që e kemi lëshuar me zë.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijën ta vejmë në kontakt të drejtpërdrejt me instrumente ose lodra që lëshojnë zë. Përmes timgëllimës fëmijët arrijnë të zbulojnë vendndodhjen e tyre, ta dallojnë tingullin dhe herë pas here t'i imitojnë melodité e tyre. Kjo do të kontrubuoj në zhvillimin e veshit muzikor sidomos ndjenjës melodike.
Fëmijët e kësja moshe dallojnë cilësitë e tingujve muzikorë duke reaguar ndaj tyre me lëvizje trupi, ritëm, duartrokitje dhe tentim për këndim.

Mosha 2-3 vjeç

Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
Aktiviteti ndihmon fëmijën të zhvilloj "veshin" muzikor
Fëmija këndon në mënyrën e vet

Aktiviteti: lojënumërim

Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmija shoqëron prindin gjatë këndimit duke i kordinuar lëvizjet

Materialet dhe mjetet: cd player-i (ose paisje tjera teknologjike)

Organizimi i aktivitetit:
Në këtë lojë me ligjerim ritmik (lojënumërim), përmes këndimit të thjeshtë me dy tre tinguj shtrojmë pyetjen: Ku janë duart ? Fëmija ngre duart lartë. Ku janë gishtat? fëmija zgjat duart dhe lëviz gishtat. Ku janë këmbët? Fëmijët shqelmojnë.
Në këtë etapë të zhvillimit të ndjenjës për ritëm te fëmijët, rekomandohen lojëra të cilat aplikohen në të folurit ritmik, si psh:
Çështë kjo? Gju-ha
Çështë ky? Ve -shi

Çështë ky? Sy-ri
Çështë kjo? Hun-da
Çështë ky? Dhëm-bi
Çështë kjo? Qa-fa
Kërkojmë nga fëmija që edhe ai ti bashkangjitet këndimit dhe ta imitoj atë që e dëgjon. Gjithashtu duhet ta stimulojmë që kohë pas kohe të këndoj sipas mënyrës së vet.

Qëllimi i këti aktiviteti është që fëmijës ti jepet mundësia të luaj, këndoj, dëgjojë muzikë dhe të shoqëroj këndimin duke e koordinuar përmbajtjen e tekstit (lojënumrimit) me lëvizje të ndryshme.
Fëmijët e kësaj moshe eksplorojnë me tingullin arrijnë të kontrollojnë zërin dhe bashkohen në këndimin e të rriturve (së paku disa fragmente). Ata poashtu vallëzojnë më kënaqësi, në shoqërim me muzikë, luajnë lojëra të ndryshme muzikore, lojënumërime etj.

Mosha 3-4 vjeç

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
- Aktiviteti ndihmon fëmijën për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vizuale
- Fëmija përdor ngjyrat sipas dëshirës

Aktiviteti: ngjyrosja e dorës (gjurmët)

Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmija zgjedh ngjyrat dhe materialet sipas disponimit

Materialet dhe mjetet: fletë A4, ngjyra të ujit, pastel, letra me ngjyra, hamer etj.

Organizimi i aktiviteti:
Fëmijën e ulim në prehër apo në karrige afër tavolinës. I ofrojmë ngjyrat e lëngshme në mes duke i dhënë mundësinë që t'i përziej ato sipas mënyrës së vet. Pastaj i marrim dorën, ia fusim në ngjyrë dhe e vendosim në fletë (ose fëmija fut dorën vet në ngjyrë dhe e vendos në lëtër). Të njëjtën gjë mund ta bëjmë edhe me dorën tjetër. Fleta mund të jetë e madhësisë së ndryshme A4, fleta të ndryshme të vizatimt, apo letër hameri. Të njëjtën do ta ruajmë si kujtim në mënyrë që fëmija me kalimin e kohës ta shohë dhe krahasoj se si është duke u rritur.

Meqë ngjyrat janë në dispozicion dhe fëmijët me shumë dëshirë i përdorin ato, aktivitetin mund ta zhvillojmë duke i dhënë mundësi fëmijës që të ngjyros sipas dëshirës dhe mënyrës së tij qoftë: pemët, perimet, kafshët, insektet, veturat, kukullat etj. I japim mundësi të krijoj art sipas mënyrës së vet.

Qëllimi i aktivitetit është që ta nxisim fëmijën të përdor ngjyra të ndryshme, t'i përziej ato dhe të krijoj art sipas mënyrës së tij/saj. Në aktivitete të tilla shpeshherë fëmijët krijojnë art pa paramendim dhe në fund i emërtojnë krijimet e tyre. *Fëmijët e kësaj moshe zgjedhin ngjyrat dhe materialet sipas disponimit, përshkruan çka i pëlqen në "krijimin" e tij\saj dhe ka dëshirë ti ekspozojë "punimet" e veta.*

Mosha 4-5 vjeç

Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
Aktiviteti ndihmon fëmijën të zhvilloj ndjenjën melodike
Fëmija këndon në lartësi të ndryshme

Aktiviteti: Loja e jehonës
Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmija këndon tinguj në lartësi të ndyshme
Materialet dhe mjetet: ambient natyre

Oraganizimi i aktivitetit:

Fillimisht i këndojmë dy tinguj të ndryshëm me rrokje të ndryshme psh: e- ja. Herën e parë e realizojmë vetë, në fillim me zë më të fortë ndërsa herën e dytë me zë më të lehtë, në mënyrë që fëmija ta kuptoj se si luhet loja. Në vazhdim tingujt i realizojmë me shprehje të ndryshme duke aplikuar tekst të ri psh: si – je, ku- je, mirë – jam etj. Ne i këndojmë rrokjet me zë më të fortë duke na imituar fëmija me zë më të lehtë duke e përjetuar jehonën. Këngën mund ta këndojmë në tempo të ndryshme për ta bërë më atraktive për fëmijën.

Këtë lojë pastaj mund ta realizojmë në natyrë ku mund të dëgjohet dhe të përjetohet jehona e zërave të ndyshëm në mënyrë të natyrshme.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të nxisim fëmijën të marrë pjesë në lojëra të ndryshme muzikore. Të këndojë këngën në lartësi dhe ritëm të ndryshëm si dhe në tempo të ndryshme gjithnjë duke e shoqëruar me lëvizje trupore dhe vallëzim. Këndimi i tingujve në lartësi të ndryshme i jep mundësi fëmijës për zhvillimin e ndjenjës melodike

Fëmija në këtë moshë identifikon ritmin, melodinë, tempin dhe "llojin" gjatë dëgjimit. Imiton lëvizje sipas rastit dhe muzikës.

38

Mosha 5-6 vjeç

- Prindi inkurajon fëmijën në zhvillimin e kreativitetit
- Aktiviteti ndihmon fëmijën për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vizuale
- Fëmija përgatitë punime të ndryshme me materiale të ndryshme.

Aktiviteti: "Mozaiku"

Pritshmëria nga ky aktivitet:
Fëmija krijon mozaik

Materialet dhe mjetet: Fleta, copëza të letrës me ngjyra, ngjitës, gërshër etj.

Organizimi i aktivitetit:

Aktiviteti mund të organizohet në mënyra të ndryshme. I japim fëmijës fletat e gatshme (të vizatuara ose të printuara) dhe kërkojmë nga ai që t'i ngjyros sipas dëshirës së vet. Aktivitetin mund ta zhvillojmë tutje duke i rritur kërkesat. Psh: marrim fletën në të cilën është e vizatuar ose e printuar delja. I japim ngjitësin dhe pambukun dhe kërkojmë nga fëmija që ta ngjes pambukun nëpër "trupin e delës". Në fund punimi i delës do të duket shumë atraktiv.
Mënyrë tjetër e organizimit të aktivitetit. I japim fletat e gatshme me përmajtje të ndyshme si: vetura, kafshë, shpezë, insekte, lule etj. Kërkojmë nga ta që copëzat e vogla të letrave me ngjyra të ndryshme t'i ngjesin në fletat e printuara, duke krijuar mozaik. Psh: kërkoni nga fëmija që të pres me gërshërë forma të ndyshme dhe të ndërtoj gjëra nga përditshmëria ku përmes argëtimit të mësoj gjëra të reja.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijën ta nxisim të përdor materiale të ndryshme si: letër, ngjyra, shkopinjë, plastelinë, blloqe nga druri, figura gjeometrike (rrethi, katrori, trekëndëshi), shpuza me vrima, rroba të ndryshme, enë të ndryshme, gjethe, ngjitës etj. Këto aktivitete ndikojnë në rritjen e kreativitetit.

Fëmija në këtë moshë krijon punime (vizatime, pikturime, mozaik etj) me më shumë detaje (p.sh. njerëzit me floke, rroba, bën maska, syze etj). Përdor art për të treguar diçka(tregim, ide etj.)